**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

---

*Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinimin të Politikave*

# Strategjia Sektoriale 2018 – 2022

# Raporti Vjetor i Monitorimit 2022

Mars 2023

# Tabela e përmbajtës

Lista e shkurtesave ... 3

**Lista e figurave** ... 4

Lista e tabelave ... 5

Lista e shtojcave ... 6

**Përmbledhje ekzekutive** ... 7

**1. Hyrje** ... 8

**2. Metodologjia** ... 10

**Figura 1: Procesi i përpilimit të raportit vjetor të monitorimit** ... 11

**3. Përmbledhje statistikore** ... 12

**3.1 Tregu i punës** ... 12

**Figura 2: Numri i përfituesve të veteranëve dhe anëtarëve të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, si dhe viktimave të dhunës seksuale** ... 18

**Figura 3: Numri i përfituesve të skemave pensionale në Kosovë** ... 19

**4. Gjetjet kryesore** ... 20

4.1 Pasqyrë e përgjithshme e realizimit të indikatoreve gjatë 2022 ... 20

**Figura 4. Përqindja e realizimit të indikatorëve sipas kategorive** ... 20

**1. Përfundimi** ... 21

**Shtojca 1. Zbatimi i indikatorëve të Strategjisë Sektoriale gjatë 2022** ... 22

## Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| ABEF | Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare |
| AFP | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| AKK | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve |
| APRK | Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| DIEKP | Departamenti për Integrim Europian dhe Koordinim të Politikave |
| DPSF | Departamenti për Politika Sociale dhe Familjare |
| GIZ | Agjencia Gjermane për Zhvillim |
| IP | Inspektorati i Punës |
| KES | Këshilli Ekonomik-Social |
| KPSHSF | Këshilli për Shërbime Sociale dhe Familjare |
| MF | Ministria e Financave |
| MIE | Ministria e Integrimeve Evropiane |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| NJMP | Njohja e Mësimit Paraprak |
| OJQ | Organizata Jo-Qeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |
| USAID | Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar |
| SDC | Zyra Zviceriane për Zhvillim |
| SNS | Skema e Ndihmës Sociale |
| SS | Strategjia Sektoriale |
| QAP | Qendra e Aftësimit Profesional |
| QPS | Qendrat për Punë Sociale |
| YES | Youth Employment and Skills |
| ZPS | Zyra për Planifikim Strategjik |

## Lista e figurave

Figura 1: Procesi i përpilimit të raportit vjetor të monitorimit..... **Error! Bookmark not defined.**1

Figura 2: Numri i përfituesve të veteranëve dhe anëtarëve të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, si dhe viktimave të dhunës seksuale ........... **Error! Bookmark not defined.**8

Figura 3: Numri i përfituesve të skemave pensionale në Kosovë.............................................19

Figura 4. Përqindja e realizimit të indikatorëve sipas kategorive **Error! Bookmark not defined.**0

Lista e tabelave

Realizimi i treguesve sipas objektivave

Lista e shtojcave

Shtojca 1: Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë Sektoriale gjatë 2022............................................

**Përmbledhje ekzekutive**

Strategjia Sektoriale 2018-2022, paraqet një përpjekje institucionale për të punuar mbi një vizion ku të gjithë qytetaret do të kenë mundësi të barabarta në punësim si dhe mbrojta dhe përfshirja sociale të jetë e garantuar për të bërë një jetë sociale dhe ekonomike të dinijiteshme. SS është miratuar në shkurt të vitit 2018 dhe përfshinë periudhën e zbatueshmërisë deri në vitin 2022. Në funksion të monitorimit dhe zbatimit të SS, është krijuar Grupi Drejtues si mekanizem formal, i cili është i obliguar ta shqyrtojë zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë dhe të dorëzojë raport tek menaxhmenti i ministror.

Prandaj ky raport paraqet monitorimin vjetor të zbatimit të Strategjisë Sektoriale 2018 – 2022. Rraporti i monitorimit përqëndrohet tek vlerësimi i zbatimit të indikatoreve gjatë vitit 2022. Mirëpo, raportimi merr në konsideratë edhe zbatimin e tyre gjatë viteve të mëparshme. Andaj, për çështje të këtij raporti, sa herë që flitet për vitin 2022, poashtu nënkuptohen edhe vitet paraprake. Kësisoj, raportimi mbi realizimin paraqet përparimin kumulativ. Raporti i monitorimit të Strategjisë Sektoriale është përgjegjësi e përcaktuar me vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili ka themeluar Grupin Drejtues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Sa i përket procesit të marrjes së informatave, është përdorur forma e raportimit e cila është zhvilluar në ciklet e kaluara të monitorimit (për vitet 2018-2021). Kjo formë e raportimit është përpiluar për të identifikuar realizimin e indikatoreve. Departamenti për Integrim Europian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP) ka dërguar kërkesën për marrjen e inputeve nga ana e institucioneve gjegjëse, të cilat në muajin shkurt/mars 2023 kanë raportuar përmes postës elektronike. Në shumicën e rasteve, lidhur me aspektin e monitorimit dhe raporimit të dokumenteve strategjike, ende mbetet sfidues raportimi lidhur me shpenzimet buxhetore.

Në fushën e punësimit, raporti analizon tregun e punës dhe shërbimet publike të punësimit, informalitetin dhe inspektimet e punës, kushtet e punës, siguria në punë dhe të drejtat e punonjësve. Në pjesën e mirëqenies sociale, raporti analizon dhe ofron informacion mbi shkallën e varfërisë, mbulimin e familjeve të varfra, sociale shërbimet dhe lidhja e shërbimeve sociale me skemat sociale. Në fushën e pensioneve, raporti përqendrohet në skemat e pensioneve, barazinë në këto skema dhe trendet e përfituesve gjatë periudhes referuese.

Raporti është ekskluzivisht i bazuar mbi inputet që janë dërguar nga dikasteret gjegjëse të ministrise. **Zbatimi i indikatoreve, bazuar në raportimet nga dikasteret gjegjëse, është klasifikuar në tri kategori kryesore: plotësisht e realizuar; pjesërisht e realizuar; e parealizuar. Kësisoj, sipas *gjetjeve kryesore* të raportit del se, nga gjithsej 43 indikator të parapara të Strategjisë:**

- **18 indikator, apo 42 %, u realizuan plotësisht;**
- **19 indikator u realizuan pjesërisht, që përbëjnë 44% e të gjitha indikatoreve të planifikuara të Strategjisë;**
- **6 indikator, nga gjithesejt 43 indikator nuk u realizuan, që perbejne 14%**

## 1. Hyrje

**Ky raport paraqet vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Sektoriale (tutje referuar si "Strategjia" ose "SS")** Specifikisht, raporti i vlerësimit është i kufizuar vetem tek monitorimi i zbatimit të treguesvee të parapare për vitin 2022, i cili paraqet vitin e pestë të implementimit të Strategjisë. Strategjia Sektoriale e MPMS-së, është miratuar në vitin 2018 dhe përfshinë periudhën e zbatueshmërisë deri në vitin 2022. Ky është **raporti i pestë** vjetor i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë.

**Ky raport synon të ofrojë një pamje të qartë lidhur me shkallën e zbatueshmërisë së Strategjisë në raport me indikatoret dhe rezultatet e synuara.** Si i tillë, raporti vlerësues, si instrument i rëndësishëm i përcaktimit të nivelit të zbatimit, synon t'i ofrojë përpiluesve dhe zbatuesve të Strategjisë një pasqyrë objektive lidhur me progresin e deritanishëm, duke identifikuar poashtu edhe fushat në të cilat ka pasur ngecje. Pra, raporti shërben, ndër tjerash, si udhërrëfyes për përshpejtimin e realizimit të objektivave të Strategjisë në fushat ku kërkohet përparim më i madh.

**Përpilimi i këtij raporti bazohet në nje metodologji të qartë, i cili ka siguruar një përfshirje të gjerë të akterevë zbatues.** Nën udhëheqjen e DIEKP, është administruar procesi i vjeljes së informatave nga departamentet dhe institucionet gjegjëse të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë. Njësitë, departamentet dhe institucionet gjegjëse kanë raportuar për realizimin e rezultateve, duke përfshirë raportimin edhe lidhur me treguesit sasiorë.

**Përpilimi i këtij raporti të monitorimit hyn në kuadër të vendimit të Qeverisë së Kosovës.** Specifikisht, sipas vendimit të datës 23 janar 2019, Ministria përkatese konform legjislacionit në fuqi, ka nxjerr vendim për caktimin e Grupit Drejtues për zbatimin dhe *monitorimin* e Strategjisë Sektoriale 2018 – 2022. Sipas këtij vendimi, Grupi Drejtues, me përbërje të gjerë ndërinstitucionale, është i obliguar ta vlerësoj zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë dhe më pas të dorëzojë raport tek menaxhmenti i Ministrisë. Poashtu, sipas vendimit, Grupi Drejtues, duke monitoruar zbatimin e Strategjisë, të jetë në gjendje të bëjë "korrigjimin dinamik të procesit në bazë të rekomandimeve të nxjerra nga informatat e fituara nga procesi i monitorimit". Ky raport i shërben pikërisht këtij procesi.

**Për më tepër, ky raport është konform përgjegjësive të përcaktuara sipas legjislacionit sekondar.** Respektivisht, raporti i vlerësimit dhe monitorimit bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Për më tepër, raporti vlerësues merr për bazë Udhëzuesin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe të Planeve të Tyre të Veprimit, i përpiluar nga Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS). Ky udhëzues ofron kornizë të dobishme lidhur me mënyrën e përpilimit të raportit vjetor për zbatimin e strategjive sektoriale, i cili është marrë për bazë në përpilimin e këtij raporti. Sipas këtij udhëzimi të ZPS-së, raporti duhet të përshkruajë progresin lidhur me reformat e zbatuara me sukses, por edhe të bëjë identifikimin e fushave të cilat kanë nevojë për përmirësim në zbatim, si dhe të paraqes realizimin e buxhetit. Por, për shkak se në shumicën e rasteve institucionet gjegjëse nuk kanë qenë në gjendje të raportojnë lidhur me realizimin e buxhetit, kjo pjesë nuk është përfshirë në raportin vjetor.

**Ky raport është i ndarë në pesë (5) kapituj.**

Struktura e raportit është me sa vijon:

- Kapitulli 1 (ky kapitull) paraqet një hyrje të përgjithshme lidhur me synimet e raportit;
- Kapitulli 2 paraqet metodologjinë e raportit;
- Kapitulli 3 paraqet një përmbledhje të përgjithshme statistikore në fushën e punësimit, të mirëqenies sociale, dhe të mbrojtjes sociale;
- Kapitulli 4 paraqet të gjeturat kryesore të monitorimit të zbatueshmërisë së Strategjisë Sektoriale gjatë vitit 2022; dhe
- Kapitulli 5 paraqet konkluzën.

## 2. Metodologjia

**Matja e shkallës së zbatueshmërisë së Strategjisë për këtë raport bazohet ekskluzivisht mbi raportimin e brendshëm institucional të akterëve gjegjës.** Njësitë, departamentet, apo institucionet të cilat janë përfshirë në raportim janë sipas vendimit të datës 23 janar 2019, sipas të cilit edhe është themeluar Grupi Drejtues për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë.

**Format e raportimit janë përpiluar në ciklet e meparëshme të raportimit dhe janë përdorur edhe për vitin 2022.** Janë specifikuar kolonat për të cilat akterët gjegjës të Strategjisë është dashur të raportojnë. Këto kolona kanë përfshirë kërkesën që institucionet të raportojnë, mbi treguesit sasiorë sipas objektivave. **Mënyra e raportimit nga akterët gjegjës është bazuar në dërgimin e inputeve përmes postës elektronike.** DIEKP ka dërguar format e raportimit (sipas strukturës së përshkruar më lart) përmes emailit tek të gjithë anëtarët e Grupit Drejtues për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë. Anëtarëve iu është dhënë afat prej rreth dy javësh që t'i raportojnë inputet e tyre duke dërguar tek DIEKP format e plotësuara. Pas dërgimit të formave të plotësuara, DIEKP ka konsoliduar inputet dhe është zhvilluar analiza. Analiza e inputeve në raste të caktuara është shoqëruar me takime tematike me zyrtar gjegjës, por edhe me korrespondencë shtesë përmes postës elektronike për marrjen e informatave plotësuse për realizimin aktiviteteve.

**Cilësia e raportimit duhet të përmirësohet në ciklet e tjera raportuese.** Përgjithësisht, raportimi nga ana e akterëve gjegjës është kufizuar në raportimin e *indikatorve* gjatë vitit 2022, pasi që në ciklet e me hereshme të raportimeve, është gjykuar si shumë ambicioze posaçërisht kërkesa për raportim të shpenzimit të buxhetit.

**Figura 1: Procesi i përpilimit të raportit vjetor të monitorimit**



# 3. Përmbledhje statistikore

## 3.1 Tregu i punës

Pandemia Covid 19, ka pasur ndikim të theksuar në trendet makroekonomike në Kosovë, ku në vitin 2020, ekonomia u tkurr për 5.3 për qind për shkak të vlerës më të ulët të shtuar të sektorëve të hotelerisë (-28.9 për qind midis 2019 dhe 2020), të ndërtimit (-7.5 për qind) dhe të tregtisë (-4.8 për qind).[1]

Ekonomia e Kosovës u rimëkëmb në vitin 2021, me një rritje të parashikuar të BPV-së prej 10.7 për qind, e nxitur nga rritja e konsumit privat (me 6.5 për qind nga viti në vazhdim), rritja rekord e eksporteve (me 50.5 për qind midis 2020 dhe 2021), flukset hyrëse të diasporës (remitencat, turizmi dhe investimet në pasuri të paluajtshme, të cilat arritën në 43 për qind të BPV-së), rritja kreditore (rritje me 15.5 për qind) dhe miratimi i pakos së rimëkëmbjes ekonomike (në masën 6 për qind të BPV-së).[2] Kjo pako ka përfshi masa për ta mbështetur punësimin (50 milionë euro); promovimin e rimëkëmbjes ekonomike (108 milionë euro) dhe shërbimet publike (112 milionë euro); përmirësimin e investimeve në infrastrukturë dhe mbrojtjen e mjedisit (100 milionë euro); dhe ndihmën për familjet në rrezik përjashtimi (50 milionë euro).

Rritja ekonomike ishte parashikuar të ngadalësohet në vitin 2022 në rreth 3.8 për qind, si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë, presioneve inflacioniste (vendi regjistroi një rritje të çmimeve të konsumit midis 2021 dhe 2022 prej 13 për qind), një përkeqësim i bilancit të llogarisë rrjedhëse dhe pasojat negative të konfliktit në Ukrainë në ekonominë e rajonit dhe të 27 shteteve BE-së. [3]

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2021, **popullsia e përgjithshme** ishte 1,798.187, prej tyre (Meshkuj: 905.128; Femra: 893.059), ndersa **popullsia në moshë pune** (15 - 64): ishte 1,231,695 (Meshkuj: 613,618; Femra: 618,077). F**uqia punëtore** (persona aktivë) ishte: 483,465 (Meshkuj: 347,605; Femra: 135,860). **Persona joaktivë:** 748,230 (Meshkuj: 266,013; Femra: 482,217). Fuqia punëtore tek të rinjtë (15-24 vjeç) ishte: 70,715 (Meshkuj: 47,051; Femra: 23,664). **Të punësuar** ishin: 383,304 (Meshkuj: 281,451 Femra: 101,853), të rinj të punësuar: (15-24 vjeç): 43,847 (Meshkuj: 31,183 Femra: 12,664). **Të papunësuar** ishin**:** 100,161 (Meshkuj: 66,154 Femra: 34,007), prej tyre të rinj të papunë (15-24 vjeç): 26,868 (Meshkuj: 15,868 Femra: 11,000).

Të dhënat e fundit në dispozicion të tregut të punës të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK 2021) tregojnë se: **Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është** 39.3%, prej tyre meshkuj 56.6%, ndërsa ka mbet shumë e ulët ne 22.0% per femra. Ndersa **Shkalla e joaktivitetit, është** 60.7%, prej tyre 43.4% meshkuj dhe 78.0% femra. **Shkalla e punësimit** shënoi një përmirësim të lehtë në terma vjetorë, duke arritur në 31.1% %, prej tyre 45.9% meshkuj, ndërsa 16.5% femra. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u përmirësua me 0.7 pp, duke

[1]ASK: Bruto Produkti Vendor (BPV) 2008 – 2021 sipas qasjes së aktiviteteve ekonomike dhe shpenzimeve, 2022.

[2]ASK: Bruto Produkti Vendor (BPV) 2008 – 2021 sipas qasjes së aktiviteteve ekonomike dhe shpenzimeve, 2022. Sipas FMN-së, flukset hyrëse të diasporës (remitencat, turizmi dhe investimet në pasuri të paluajtshme) ishin mesatarisht 37.5% të BPV-së në 2018-19. Kjo ra në 31% në vitin 2020, por tejkaloi nivelin e periudhës para pandemisë në vitin 2021, duke arritur rreth 43% të BPV-së. Niveli i kredisë u rrit me 15.5 për qind gjatë vitit 2021 (kredia për individët me 18.6 për qind dhe për korporatat me 13.6 për qind).

[3]Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) "Kosova: Profili i Aktit të Biznesit të Vogël", në *Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019: Vlerësimi i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, Indeksi i Politikave për NVM-të*, Botim i OECD, Paris, 2019,https://doi.org/10.1787/dd53f292-en.

arritur në 39.3%. Shkalla e papunësisë u zvoglua me në terma vjetorë duke arritur në 20.7%, e cila po ashtu ishte më e theksuar te femrat (25.0%).

**Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re** (15-24 vjeç) është 32.1%, prej tyre 31.8% meshkuj, ndërsa 32.4% femra. Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm është 12.7%, prej tyre 14.9% meshkuj dhe 6.8% femra.

Sektorët me punësimin më të lartë janë tregtia me 16.8% të punësimit total, pasuar nga ndërtimi me 10.5%, prodhimi me 10.4% dhe arsimi me 10.1%. Punësimi i meshkujve ishte më i lartë në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit, ndërsa punësimi i femrave ishte më i lartë në sektorët e arsimit, tregtisë dhe shëndetësis.

Për sa i përket llojit të kontratës, 86.9% kishin një kontratë individuale, ndërsa 8.6% punonin pa kontratë, 2.8% kontratë kolektive me punëdhënësin. 0.4% kontratë grupi dhe 1.3% kontratë kolektive me sindikatën.

Sipas Agjencisë të Punësimit të Republikes së Kosovës, gjatë vitit 2022 të papunë të regjistruar që kanë marrë pjesë në MATP (përveç aftësimit profesional) ishin 2012 persona. Nga ky numër, 762 ishin meshkuj ndërsa 1250 ishin Gra. Numri i të papunëve që u ndërmjetësuan në punësim të rregullt ishte 4459. Nga ky numër, 2313 ishin meshkuj ndërsa 2146 ishin Gra. Nderkaq numri i kandidatëve që kanë marr pjesë në trajnim në Qendrat për Aftësim Profesional arrijnë shifrën prej 2,797 kandidatë. Po ashtu përfitues në trajnimin e kombinuar në QAP - Kompani ishin 62 persona. Nnumri i të papunëve që përfituan këshillim në karrierë ishte: 26415 persona.

**Tabela 1 Treguesit kryesorë të tregut të punës**

| Treguesi | 2018 | 2019 | 2020 | TM1 2020 | TM1 2021 | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej popullsia | **1,793,467** | **1,796,376** | **1,795,666** | **1,795,666** | **1,798,188** | 1,798.187 |
| **Meshkuj** | 903,959 | 903,430 | 900,694 | 908,434 | 906,807 | 905.128 |
| **Femra** | 889,508 | 892,946 | 894,972 | 887,232 | 891,381 | 893.059 |
| Popullsia në moshë pune | **1,190,272** | **1,206,806** | **1,222,104** | **1,218,112** | **1,225,729** | **1,231,695** |
| **Meshkuj** | 600,092 | 605,877 | 608,885 | 611,511 | 609,706 | 613,618 |
| **Femra** | 590,180 | 600,929 | 613,219 | 606,601 | 616,023 | 618,077 |
| Fuqia punëtore | **490,103** | **488,485** | **468,450** | **472,669** | **483,823** | **483,465** |
| **Meshkuj** | 379,763 | 361,514 | 340,764 | 349,319 | 344,239 | 347,605 |
| **Femra** | 110,340 | 126,971 | 127,686 | 123,350 | 139,584 | 135,860 |
| Të punësuar | **345,131** | **363,180** | **347,071** | **354,672** | **359,167** | **383,304** |
| **Meshkuj** | 271,623 | 279,938 | 260,591 | 269,071 | 261,098 | 281,451 |
| **Femra** | 73,508 | 83,242 | 86,480 | 85,601 | 98,069 | 101,853 |
| Shkalla e Pjesëmarrjes në Fuqinë Punëtore (LFPR) | **41.18%** | **40.48%** | **38.33%** | **38.80%** | **39.50%** | **39.3%** |
| Shkalla e punësimit | **29.00%** | **30.09%** | **28.40%** | **29.10%** | **29.30%** | **31.1%** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shkalla e papunësisë | **29.58%** | **25.65%** | **25.91%** | **25.00%** | **25.80%** | **20.7%** |

Të dhënat e ATK-së tregojnë një rritje të moderuar të punësimit formal prej 4.0%, që është në përputhje me zhvillimet kryesore në aktivitetin ekonomik.

**Shkalla e papunësisë**[4]

**Shkalla e papunësisë në vitin 2021 shënoi 20.7% krahasuar me 25.9% në 2020.** Sipas AFP-së 2021 në Kosovë ka pasur 101,161 persona të moshës 15-64 vjeç, që ishin të papunë, 66,154 nga të cilët ishin meshkuj dhe 34,007 femra. Shkalla e papunësisë ishte 20.7 %, më e lartë ishte tek femrat me 25.0% se sa te meshkuj, 19.0 %. Krahasuar me vitin paraprak të AFP-së (2020) në Kosovë, kemi rënie të shkallës së papunësisë me 5.2%, ku kjo rënie te meshkujt ishte 4.5%, përderisa te femrat kemi rënie me 7.3%.

Bazuar në AFP-në e vitit 2021, 26.8% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 8.3 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave. Në vitin 2021, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me 0.3 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave. Gjate vitit 2021, shkalla e papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 është ulur 38.0%, nga 49.1% qe ishte në 2020. Sipas AFP 2021, tek të rinjtë e moshës 15-24 shkalla e papunësisëte meshkujt është 33.7%, ndërsa tek femrat papunësia është 46.5%. Ndersa shkalla më e ulët e papunësisë është hasur në mesin e personave të moshës 55-64 vjeç (9.8%). Shkollimi ka përmirësuar perspektivat në tregun e punës, në veçanti për meshkujt pasi 40.9% e meshkujve të pashkolluar ishin të papunë, në krahasim me 12.3% të atyre që kishin përfunduar arsimin terciar. **Kohëzgjatja e papunësisë** sipas të intervistuarve te papunë, 70.8% kane raportuar se janë të papunë për më gjatë se 12 muaj. Janë vërejtur dallime gjinore me 1.2 pikë diference midis meshkujve dhe femrave (71.2% e meshkujve dhe 70.0% e femrave).

**Sa i përket pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për 2021,** ishte **39.3 %, ku** në mesin e femrave ishte shumë më e ulët se në mesin e meshkujve: 22.0 % e femrave ishin aktive në krahasim me 56.6 % e meshkujve. **Sipas AFP gjatë 2021,** nga numri i popullsisë prej 1,798.187 milion, mbi dy të tretat, ose 1.2 milion kosovarë, konsiderohet se janë në moshë pune, nga të cilët afërsisht 905.128 janë burra dhe 893.059 janë gra.

Te punësuarit dhe të papunët së bashku përbëjnë Fuqinë Punëtore (ose personat ekonomikisht aktivë). Nga 39.3 % (483,465 persona) e popullsisë, që është ekonomikisht aktive, 20.7% (100,161 persona) janë të papunë, perderisa 60.7 % e popullsisë në moshë pune ishte ekonomikisht joaktive). Jo aktiviteti në tregun e punës ka karakter të theksuar gjinor: 43.5% e personave ekonomikisht joaktiv janë meshkuj, ndërsa 77.3% janë femra. Shkalla e jo aktivitetit është rritur nga 59.5% në 2019 në 61. 7% në vitin 2020, përderisa ka pasur një zbritje gjate vitit 2021 në 60.7%. Krahasuar me vitin paraprak të AFP-së (2020) në Kosovë, kemi rënie te shkalla e jo aktivitetit me 1.7%, ku kjo rënie te meshkujt ishte 0.6% përderisa te femrat kjo rënie ishte 1.2%. Pjesëmarrja më e madhe është në mesin e femrave se në mesin e meshkujve: 78.0% e femrave ishin jo aktive në krahasim me 43.4% e meshkujve.

[4] AFP 2021

Krahasuar me vitin paraprak të AFP-së (2020) në Kosovë, kemi rritje te shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore me 1.0%, ku kjo rritje te meshkujt ishte 0.6% përderisa te femrat kjo rritje ishte 1.2%. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ishte më e larta në mesin e personave të moshës 30-34 vjeç (53.6 %) dhe më e ultë në mesin e personave të moshës 15 deri 19 vjeç me 8.0 %. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes së të rinjve nuk është për t'u habitur sepse shumica e këtij grupi ndjekin shkollën. Tek meshkujt, moshat 35-39 vjeç kishin shkallë më të lartë pjesëmarrjeje (74.7 %), ndërsa për femrat shkalla më e lartë ishte në grup moshën, 25-29 vjeç (35.8 %).

**Hendeku gjinor në tregun e punës**

Sipas ASK 2021, nga e gjithë popullsia në moshë pune, 31.1 % ishin të punësuar. Shkalla e punësimit ishte më e lartë për meshkuj se sa për femra: 45.9 % të meshkujve në moshë pune ishin të punësuar krahasuar me 16.5 % të femrave po ashtu ne moshë pune. Krahasuar me vitin e kaluar (2020) të AFP-së në Kosovë, kemi rritje të shkallës së punësimit me 2.7 %, ku kjo rritje te meshkujt ishte 3.1 % përderisa te femrat kemi rritje për 2.4 %.

Shkalla e punësimit nëpër grup mosha ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç (40.4%) dhe më e ultë në mesin e të rinjve (15-24 vjeç) (13.4 %). Shkalla e punësimit te femrat për grup moshat 25-54 vjeç sillet nga 17.6% deri në 24.1%. Në grup moshën 25-34 vjeç shkalla e punësimit është 24.1% ku kemi rënie me 2.9 % në grup moshën 35-44 vjeç (21.2%) ndërsa kemi rënie me 3.6% krahasuar me grupe moshën 45-54 vjeç (17.6%). Ndërsa femra të punësuara në grup moshën e re (15-24 vjeç), ishin vetëm 8.0% derisa në grup moshën e vjetër (55-64 vjeç) ishin 13.5 %. Tek meshkujt, shkalla e punësimit ishte më e larta për grup moshën 35 deri 44 vjeç (61.9%), pasuar me grup moshën 45 deri 54 vjeç (59.6%) dhe më e ultë për të rinjtë në grup moshën 15 deri 24 vjeç (18.4%).

Sipas AFP 2021, sa më i lartë të jetë shkollimi aq më e lartë do të jetë mundësia për të u punësuar (71.7% te meshkujt dhe 53.4% te femrat).

Sa i perket statusit te punësimit, sipas AFP (2021), 78.0% e personave të punësuar ishin punonjës, 9.3% ishin të vetë-punësuar dhe kishin punonjës të tjerë, 9.8% ishin të vetë-punësuar pa punonjës të tjerë dhe 2.9% ishin punëtorë familjarë. Shumica e femrave të punësuara kishin statusin e punonjësit (88.3% krahasuar me 74.3% për meshkujt).

Përveç shkallës së ulët të punësimit në Kosovë, **12.7 % e personave të punësuar punonin në vende pune të paqëndrueshme.** Punëtorët në punë të paqëndrueshme **janë ose persona të vetëpunësuar pa punonjës, ose ata që punojnë pa pagesë në një biznes familjar.** Këto dy grupe punëtorësh kanë gjasat më të ulta të kenë një marrëveshje formale pune në krahasim me punëtorët me pagesë dhe rrogë. **Meshkujt kanë më shumë gjasa të mbajnë punë të tilla të paqëndrueshme (14.9 % e meshkujve të punësuar krahasuar me 6.8% të femrave të punësuara).** Shprehur në numra absolutë, **48,757 persona nga 383,304 të punësuar i përkasin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm.** Të punësuarit në fusha profesionale kanë më

pak gjasa të jenë të punësuar në punë të paqëndrueshme si dhe personat me nivel të lartë arsimimi.

Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore qëndroi në 39.5% në 2020, ka pasur një hendek të gjerë gjinor. Veçanërisht, **niveli i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të grave ishte 22.0% gjatë 2021, krahasuar me 56.6% në mesin e burrave.** Në vitin 2018, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në shkallë kombëtare ishte 40.9%, ndërsa shkalla e pjesëmarrjes së fuqinë punëtore të grave ishte 18.4% krahasuar me 63.3% të burrave. Vlen të përmendet se rritja e fuqisë punëtore e dëshmuar në vitin 2020, në krahasim me dy vite më parë, ishte nxitur nga rritja e numrit të grave që kërkonin punë.

**Hendeku i gjerë gjinor vazhdon sa i përket shkallës punësimit dhe papunësisë tek femrat. Në vitin 2021**, shkalla e punësimit ishte 16.5% tek femrat, krahasuar me 45.9% tek meshkujt, ndërsa shkalla e papunësisë tek femrat ishte 25.0%, krahasuar me 19.0% tek meshkujt. **Në vitin 2020,** shkalla **e** punësimit ishte 14.1% tek femrat, krahasuar me 42.8% tek meshkujt, ndërsa shkalla e papunësisë tek femrat ishte 32.3%, krahasuar me 23.5% tek meshkujt**. Në vitin 2019**, shkalla **e** punësimit ishte 12.3% tek femrat, krahasuar me 45.3% tek meshkujt, ndërsa shkalla e papunësisë tek femrat ishte 34.4%, ndërsa ishte në 22.6 % tek meshkujt.

**Shkalla NEET dhe papunësia afatgjatë (PA)**

Sipas AFP 2021, të rinjtë e grupi NEET përfshijnë të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën, as nuk trajnohen, d.m.th. janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë e të rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregon shkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar në vendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen e fitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemeve sociale. Në vitin 2021, ishin 105,132 të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim dhe përbënin 32.1 % të popullsisë së re. Pjesa e femrave NEET është 32.4% krahasuar me 31.8% të meshkujve.

**Shkalla e papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 është ulur nga 49.4% në 2019 në 49.1% në 2020, si dhe në 38.0 % në 2021 (me një diference prej % krahasuar me vitin 2019).** Bazuar në AFP-në e vitit 2021, 26.8% e të papunëve në Kosovë ishin të rinj (të moshës 15-24 vjeç) me 8.3 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së re është e papunë (38.0%) dhe shkalla e papunësisë tek rinia e gjinisë femërore është më e lartë (46.5 %) krahasuar me meshkujt (33.7%).

Sipas AFP 2021, pjesëmarrja e të rinjve të papunë në papunësinë e përgjithshme është 26.8%, prej tyre 24.0% meshkuj dhe 32.3% femra. Ndërsa Pjesëmarrja e të rinjve si të papunë në popullsinë e re është 38.0%, prej tyre 33.7 meshkuj dhe 46.5% femra. Në vitin 2021, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë në krahasim me të rriturit, me 0.3 pikë diferencë midis meshkujve dhe femrave.

Rreth 67% e të papunëve të regjistruar konsiderohen të papunë afatgjatë, ndërsa, përqindja e të rinjve në kategorinë NEET është rritur nga 32.7% në 2019 në 33.6% në 2020 (33.2% tek femrat e reja dhe 34.0% tek meshkujt), përderisa është shënuar një zbritje në TM1 2021 në 29.8% (me një diference prej 3.8 % krahasuar me vitin 2020.

**Natyra e punësimit**

Shkalla e punësimit në vitin 2021 është rritur në 31.1%, përderisa në vitin 2020 ka qenë 28.4%, ndërsa në vitin 2019 shkalla e punësimit ka qenë 30.1%. Krahasuar me vitin paraprak 2020, kemi rritje të shkallë së punësimit me 2,7%, ku per meshkujt me 3.1 % derisa rritje punësimi te femrat 2.4 %. Sektorët me punësim më të lartë vazhdojnë të jenë: Tregtia punësonte 16.8%, duke vazhduar me ndërtimtarinë me 10.5%, prodhimin me 10.3% dhe arsimin me 10.1 %, të personave të punësuar në Kosovë. Arsimi, tregtia dhe kujdesi shëndetësor ishin tre punëdhënësit kryesorë për femrat (duke punësuar 51.8% të femrave të punësuara). Tregtia, ndërtimtaria dhe prodhimi janë sektorët më të zakonshëm të punësimit për meshkujt (duke punësuar 41.8 % të meshkujve të punësuar).

### 3.2. Mirëqenia sociale[5]

Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2022, numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 22,980 familje, ndërsa në muajin dhjetor 2021, numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 25,895 familje.

Numri më i madh i familjeve ishte në komunën e Mitrovicës me gjithsej 2,186. Krahasuar me vitin paraprak kemi një ulje të numrit të familjeve që kanë përfituar nga SNS. Në muajin dhjetor 2022, numri i anëtarëve të familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 90.806 anëtarë. Numri më i madh i anëtarëve ishte në komunën e Mitrovicës me gjithsej 8.885 anëtar.

Numri mesatar i familjeve, përfituese të Skemës së Ndihmës Sociale gjatë vitit 2022, për muaj ishte 23.661 familje, në vitin 2020 ishte 25,895 familje, ndërsa gjatë vitit 2019 numri mesatar i familjeve në SNS ishte 24.891 familje në muaj.

Këto shifra reflektohen edhe në terma të anëtarëve të familjes që kanë përfituar nga Skema e Ndihmës Sociale Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2022, numri i anëtarëve te familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 90.806, ndërsa në dhjetor 2021 numri i anëtarëve te familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale ishte 102,904 anëtarë.

Numri më i madh i anëtarëve ishte në komunën e Mitrovicës me gjithsej 8.885 e numrit të përgjithshëm. Numri mesatar i anëtarëve të familjes që kanë përfituar nga SNS gjatë vitit 2022 muaj ka qenë 100.395 anëtarë, ndërsa numri mesatar i anëtarëve gjatë vitit 2020, për muaj ka

[5] ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale

qenë 99.653 anëtarë, kurse gjatë vitit 2019 kjo mesatare ishte 100.687 anëtarë të familjes në muaj.

Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2022, numri i përfituesve nga skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara ishte 2.921, nërsa në dhjetor 2021 numri i përfituesve nga skema për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara ishte 2,460. Numri më i madh i përfituesve ishte në komunën e Prishtinës me gjithsej 407 për muajin dhjetor 2022, ndërsa në dhjetor 2021 numri i përfituesve ishte me gjithsej 344, apo 14 % e numrit të përgjithshëm. **Numri mesatar i** fëmijëve që kanë përfituar nga kjo Skemë gjatë vitit 2022, për muaj ishte 2.612, ndërsa gjatë vitit 2020, për muaj ishte 2.321 fëmijë ndërsa gjatë vitit 2019 numri mesatar i fëmijëve ishte 2.166 fëmijë në muaj.

**Në skemat e veteranëve të luftës, pensionet për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, ka nje trend të rritjes së përfituesve në vitin 2022 krahasuar me vitin paraprak.** Sipas të dhënave, numri i veteranëve të cilët përfituan nga shteti u ule nga 38,216 në vitin 2020, në 36,804 në 2021, ndërsa në vitin 2022 kemi rritje 36.825 ( dmth 21 veteran me shumë se viti paraprak).[6]

Ndërkaq, në kuadër të pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, numri i përfituesve është ulur nga 13,550 në vitin 2020 në 13,293 në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 numri i përfituesve është ulur 13.067.[7]

### Figura 2: Numri i përfituesve të veteranëve dhe anëtarëve të familjeve të dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës, si dhe viktimave të dhunës seksuale

| Skemat | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Skema Familjare – Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile** | 13,138 | 10,493 | 13,550 | 13.293 | 13.067 |
| **Skema e Veteranëve** | 38,345 | 38,101 | 38,216 | 36,804 | 36.825 |
| **Skema e Viktimave të Dhunës Seksuale** | 167 | 606 | 882 | 1023 | 1.356 |
| **Totali** | **51,650** | **49,200** | **52,648** | **51,120** | **51.248** |

**Numri i përfituesve të skemave pensionale në Kosovë përgjithësisht ishte ulur në vitin 2022 krahasuar me atë paraprak.** Bazuar në gjendjen e muajit dhjetor 2022, numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës ishte 144.015. Numri më i madh i përfituesve ishte

[6] ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale

[7] ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale

në komunën e Prishtinës me gjithsej 15.326 e numrit të përgjithshëm. Numri i përfituesve të pensioneve bazike të moshës është ulur në vitin 2022 krahasuar me vitin praprak, nga 148,162 përfitues në vitin 2021, në 144.015 përfitues në vitin 2022. Një ulje e përfituesve verehet edhe tek pensionet kontributpaguese të moshës, ku nga 49,872 persona sa ishin në vitin 2021, është ulur në 48.428 në vitin 2022. Nderkaq numri i përfituesve të pensionit për persona me aftësi të kufizuara është rritur nga 18,903 sa ishin në vitin 2021, në 19.419 përfitues në vitin 2022. Nderkohë, tek numri i përfituesve të pensionit të Trepçës verehet një trend i uljes së përfitueseve ku nga 2.028 persona në vitin 2021, është ulur në 1.736 në vitin 2022.

Numri i përfituesve të pensionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës është rritur nga 625 në vitin 2021, në 699 në vitin 2022. Numri i përfituesve të pensionit të Trupave Mbrojtëse të Kosovës po ashtu është rritur nga 1,223 sa ishin në vitin 2021, në 1.281 në vitin 2022. [8]

### Figura 3: Numri i përfituesve të skemave pensionale në Kosovë

| **Skema** | **2018** | **Viti 2019** | **Viti 2020** | **Viti 2021** | **Viti 2022** |
|---|---|---|---|---|---|
| Pensioni Baze | 126888 | 133917 | 142280 | 148,162 | 144.015 |
| Pensioni Kontributiv | 45391 | 47486 | 49451 | 49,872 | 48.428 |
| Pensionet e TMK | 817 | 1098 | 1166 | 1,223 | 1.281 |
| Pensionet e PAK-së | 17998 | 17791 | 19266 | 18,903 | 19.419 |
| Pensionet e FSK-së | 482 | 546 | 583 | 625 | 699 |
| Kompensimi per Persona të Verbër | 2021 | 1976 | 1848 | 1,772 | 1.855 |
| Pensionet e Parakohshme Trepça | 2950 | 2635 | 2341 | 2.028 | 1.736 |
| Pensioni Invalidor i Punës | 101 | 108 | 81 | 68 | 60 |
| Pensioni Familjar | 4031 | 3941 | 3713 | 3.545 | 3.304 |
| Kompensimi i Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik | 2986 | 3106 | 2797 | 2,662 | 2.542 |
| Kompensimi per punëtoret e arsimit | 0 | 10087 | 11530 | 12,215 | 12.878 |
| **Totali** | **203665** | **222691** | **235056** | **241,075** | **236,217** |

[8] ASK, Statistikat e Mirëqenies Sociale

## 4. Gjetjet kryesore

### 4.1 Pasqyrë e përgjithshme e realizimit të indikatoreve gjatë 2022[9]

**Vlerësimi i realizimit të treguesve sasiorë bazohet ekskluzivisht në raportimet nga ana e institucioneve gjegjëse.** Bazuar në inputin e departamenteve dhe njësive raportuese, të gjithë indikatoret janë vlerësuar sipas tri (3) kategorive kryesore. Më saktësisht, janë përcaktuar këto kategori të vlerësimit:

1. "*Plotësisht e realizuar*" – e aplikuar në rastet kur indikatoret gjykohen të jenë realizuar në plotëni, duke përfshirë indikatoret që kanë arritur cakun për vitin 2021 (në rast se ky cak është përcaktuar në Strategji), si dhe në rastet kur – kumulativisht për vitet 2018–2022 është arritur caku i përcaktuar kohor;
2. "*Pjesërisht e realizuar*" – e aplikuar në rastet kur përpjekjet për realizimin e indikatoret të paraparë kanë filluar, por shkalla e zbatueshmërisë dallon nga indikatori në indikator, por që nuk janë realizuar plotësisht;
3. "*Nuk është realizuar*" – e aplikuar në rastet kur nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet i cili është paraparë të fillojë gjatë 2018-2022;

**Sipas vlerësimit të zbatimit të Strategjisë Sektoriale,** nga gjithsej 43 indikator të paraparë, **18 indikator apo 42 % janë cilësuar si "*plotësisht të realizuara*", 6 indikator *nuk janë realizuar*, që përbëjnë 14% e të gjithë indikatoreve të planifikuar të Strategjisë. Ndërsa 44% e të gjithë indikatoreve janë "*realizuar pjesërisht*", apo 19 nga 43 indikator Për më tepër informata shih figurën e mëposhtme.**

**Figura 4. Përqindja e realizimit të indikatorëve sipas kategorive**




9 Raportimi mbi realizimin e indikatoreve poashtu merr në konsideratë edhe zbatimin e tyre gjatë viteve 2018-2022. Kësisoj, për çështje të këtij raporti, sa herë që flitet për vitin 2022, poashtu nënkuptohen edhe vitet paraprake. Pra, raportimi është kumulativ.

1. **Përfundimi**

Bazuar në gjetjet e raportit **ekziston një numër i rezltateve të cilat nuk janë zbatuar ende**. **Në këtë drejtim vërehen efektet e pandemisë së COVID 19, në ngadalësimin ekonomik dhe situatën e tregut të punës, si dhe ri-organizimi institucional i sektorit të punësimit dhe mirëqenies sociale, të cilat direkt kanë ndikuar progresin e zbatimit të Strategjise Sektoriale**. Sidoqoftë këta indikator si dhe indikatoret ku statusi i realizimit të tyre është i pjesërishëm, nuk janë realizuar as gjatë vitit 2022. Nisur nga fakti se disa nga rezultatet e reformave janë projektuar në një periudhë afatgjate, **ministria duhet ta shqyrtoj relevancen e tyre, si dhe ti konisderoj riprioritzimin e këtyre masave në fazen e ardhshme planifikuese.**

**Treguesit për arritjen e objektivave në disa raste nuk përcaktojnë arritjet specifike**, dhe si rezultat, vlerësimi dhe krahasimi i tyre është i vështirë. Për më tepër, treguesit sasiorë nuk janë të mjaftueshëm për të vlerësuar arritjet. Prandaj, përveç përqendrimit në arritjen e këtyre indikatorëve të parashikuar në SS, **duhet të përqendrohemi në standardizimin dhe menaxhimin e duhur të këtyre treguesve.** Përkundër qasjes dhe kërkesave të ZPS, në raport me identifikimin e treguesve, **rekomandohet të punohet që caqet në ciklin e ardhshem planifikues të vendosen për secilin vit, duke përfshirë edhe përmirësimin e cilësisë së formulimit të treguesve.**

**Raporti monitorues ka identifikuar, përmes kategorizimit të shkallës së zbatueshmërisë, fushat në të cilat kërkohet vëmendje më e madhe.** Kësisoj, raporti monitorues shërben si mjet i paralajmërimit por edhe shqyrtimit të pozicionit strategjik të ministrisë, konform rrethanave të reja institucionale përfshirë qasjen e re programore të Qeverisë, lidhur me fushën e punësimit.

**Është e qartë se, në ciklet e radhës, cilësia e raportimit nga ana e njësive e departamenteve gjegjëse duhet të jetë edhe më e plotë dhe më cilësore.** Përkundër përpilimit të formave të raportimit të cilat janë bazuar në udhëzuesin përkatës të Zyrës për Planifikim Strategjik, informatat në masë të madhe nuk janë ofruar lidhur me shpenzimet buxhetore, identifikimin e pengesave dhe rreziqeve.

## Shtojca 1. Zbatimi i indikatorëve të Strategjisë Sektoriale gjatë 2022

| Objektivi strategjik 1: Rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mirë i tregut të punës | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik 1.1** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve gjatë 2022**<br>**Plotësisht e realizuar** / **Pjesërisht e realizuar** / **Nuk është realizuar** |
| **Forcimi i kapaciteteve të Shërbimeve Publike të Punësimit** | 1. Përqindja e stafit të ShPP-ve të trajnuar nga SBT | 0 | 100% | 100% | Gjate vitit 2022 sa i perket ngritjes se kapaciteteve te trajnerëve të QAP, me mbështetje te projektit të ALLED II janë trajnuar 7 Kordinatoret per Sigurim të Cilësisë dhe 7 Udhëheqësit e QAP ne fushën ‘’Sigurimi i Cilësisë, po ashtu me mbështetje te LUX – Development janë trajnuar dhe certifikuar 15 trajner per NJMP dhe ***3 Trajner janë trajnuar dhe* certifikuar *për Corriculum Globale të mbështetur nga DVV-Internacional dhe fakulteti i Edukimit***<br><br>***Me mbështetje*** të projektit EYE është zhvilluar trajnimi i 3 trajnerve të kontabilitetit dhe 1 zyrtare nga DAP në programin QuickBooks.<br><br>Me beshteje të projektit të GIZ është mbajtur trajnimi për 10 Keshilltaret e Punësimit me temen ‘’Orientimi në Karrierë’’.<br><br>Me mbeshtjetjen e projektit Swisscontact/ Boost Employment janë trajnuar 13 keshilltarë në temën Këshillimi drejt Punësimit dhe Sipermarrjes.<br><br>Në bashkëpunim me GIZ DIMAK, IOM janë realizuar trajnime per 30 persona sa i përket fushës së migrimit për zyrtaret e APRK-së me temat:<br><br>Pra ne total **numri i zyrtareve të SHPP të përfshirë në trajnime gjatë vitit 2022 është 74 zyrtar**<br><br>Nderkaq në kuadër të forcimit të kapaciteteve të SHPP-ve gjatë vitit 2021, **12 zyrtarë të SHP** kanë vijuar trajnim në Ofrimin e Karrierës dhe të shërbimeve |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të migracionit. Me organizimin e Institutit për Ndërmarrësi dhe Biznese të Vogla (IESB) janë trajnuar **10 zyrtarë nga APRK** për Aplikimin e Statistikës në SPSS. Në kuadër të Projektit të ËYG është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit të APRK ne procesin e monitorimit dhe te vlerësimit te përfituesve te grandeve nga BE. Poashtu janë trajnuar **29 Zyrtare** të APRK në temën "Përmirësimi i qasjes në tregun e punës të grupeve të pafavorizuara përmes ndërmarrjeve sociale dhe masave aktive të tregut të punës" Gjatë periudhës raportuese **26 zyrtarë u trajnuan** me temen zbatimi i aktiviteteve te këshillimit të grupeve të cenueshme, i mbështetur nga Sëisscontact - Sëiss Foundation for Technical Cooperation. Me tej në kuadër të trajnimit "Integrimi i Shërbimeve Sociale me Tregun e Punës (APDEC), **janë trajnuar 74 Zyrtare** nga APRK. Janë realizuar trajnime për trajnerët metalpunues, po ashtu janë trajnuar edhe trajnerët e saldimit dhe koordinatorët e Cilësisë për implementimin e NJMP në QAP Gjilan dhe Mitrovicë. Me mbështetje të ALLED 2 janë zhvilluar trajnime për Sigurim të Cilësisë në QAP- ku pjesëmarrës ishin Udhëheqësit e Qendrave dhe Koordinatorët për Sigurim të Cilësisë. **Numri total i përfshirë në trajnim nga Qendrat e Aftësimit Profesional është 22 persona**<br><br>**Pra, në total numri i zyrtareve të SHPP të përfshirë në trajnime gjatë vitit 2021 është 173 zyrtar.**<br><br>**Mirëpo shprehur në mënyrë kumulative nga viti 2018 deri me tani janë trajnuar rreth 350 zyrtare të SHPP.** Prandaj, në raport me caqet e planifikuara dhe numrin e zyrtareve të SHPP të përfshirë në trajnime, konsiderohet se ky indikator është realizuar.[10]<br><br>**Plotesisht e realizuar** |
| | 2. Numri i objekteve të ZP-ve dhe QAP-ve të | NA | 6 | | **Sa i përket infrastrukturës fizike** në 3 Qendrat e Aftesimit Profesional gjatë vitit 2022 janë bërë disa ndërhyrje në objekte për qasje të personave me aftësi të kufizuara, ky aktivitet është mbeshtet nga Save the Children. |

[10] Numri i punëtorëve në APRK, prej vitit 2018, ne raport me gjendjen aktuale është zvogëluar dukshëm

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | rinovuar dhe ndërtuar | | | | Nderkaq në vitet paraprake janë rinovuar disa objekte të QAP dhe ZP: Gjatë vitit 2018 është bërë renovimi i kulmeve të dy (2) QAP-ave: Prishtinë dhe – Ferizaj. Ndersa gjatë viteve 2019-2020 janë bërë rinovimet brenda dhe jashtë të dy ( 2) QAP- Prizren dhe QAP-Gjilan, si dhe ndërtimi i një (1) ZP, në Kacanik.<br><br>Ky indikator është realizuar pjesërisht pasi që në raport me cakun e vendosur nuk është arritur të realizohet.<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |
| | 3. Numri i akteve ligjore nga fusha e punësimit dhe aftësimit profesional të hartuara si dhe ndryshuara dhe plotësuara | NA | 5 | / | **Gjatë vitit 2022 kemi pasur këto zhvillime:**<br><br>1. Është hartuar koncept dokumenti për rregullimin e fushës së punësimit. Koncept dokumenti është finalizuar dhe është dërguar për komente në Kabinet, dhe pastaj do të vendoset për konsultime publike.<br><br>2. Është hartuar Politika e Punësimit 2022 - 2024. Politika e Punësimit 2022 – 2024 është finalizuar dhe është dërguar për komente në Kabinet, dhe pastaj do të vendoset për konsultime publike.<br><br>Kemi filluar procesin e hartimit të Strategjisë së Punësimit dhe të tregut të punës 2022 – 2027. Strategjia është në fazën e finalizimit të draftit të parë dhe gjatë muajit mars do të mbahet punëtoria për diskutimin dhe finalizimin e masave për nxitjen e punësimit.<br><br>Aktivitetet që janë ndërmarr deri me tani jane si ne vijim:<br><br>1. Ka përfunduar hartimi i raportit të vlerësimit ex post të Ligjit për Agjencinë e Punësimit;<br><br>2. Kemi hartuar Politikën e Punësimit si dhe të njëjtën e kemi ri shikuar çdo fund vit;<br><br>Janë hartuar dhe aprovuar këto akte nënligjore: |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1. Rregulloren për lehtësirat tatimore dhe doganore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuar si dhe për personat me aftësi të kufizuar që ushtrojnë veprimtari të pavarur;<br><br>2. Udhëzimin Administrativ për punëdhënësit që nuk punësojnë personat me aftësi të kufizuar; Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e aftësisë së mbetur për punë;<br><br>3. Udhëzimi Administrativ për Komisionin Mediko – Social për vlerësimin e aftësisë së mbetur për punë;<br>4. Rishikimi i Rregullores për masat aktive të tregut të punës;<br><br>5. Ri shikimi Udhëzimit Administrativ për licencim të ofruesve jo publik të shërbimeve të punësimit;<br><br>6. Janë hartuar dhe aprovuar aktet nënligjore nga fusha e ndërmarrësis sociale.<br><br>**<u>Plotesisht e realizuar</u>** |
| **Objektivi specifik 1.2.** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve gjatë 2022** |
| **Zgjerimi i shërbimeve të punësimit dhe MATP-ve, si dhe ngritja e efiçencës dhe cilësisë së tyre** | 1. Shkalla e punësimit | 28.0% | 31.6% | 33.6% | **Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore** në vitin 2021, shkalla e punësimit është 31.1 %, shkalla e papunësisë është 20.7 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 60.7 %.<br><br>**<u>Pjesërisht e realizuar</u>** |
| | 2. Numri i të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga | Nuk ka të dhëna | 20,000 | 20,000 | Gjatë vitit 2022, numri i të papunëve që përfituan **<u>këshillim në karrierë ishte: 26415persona.</u>**<br><br>Ndersa shikuar në total nga viti 2018 deri me tani numri i atyre që përfituan **<u>këshillim në karrierë ishte: 136, 151</u>** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | këshillimi për karrierë | | | | • **2018: 30,228.**<br>• **2019: 16,841.**<br>• **2020: 32147**<br>• **2021: 30520**<br>• **2022: 26415**<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| | 3. Numri i të papunëve të regjistruar që marrin pjesë në MATP (përveç aftësimit profesional) | 2732 (948 F, 1784 M)[11] | 8000 (3200, F 4800 M) | 8000 (4000, F 4000 M) | Gjatë vitit 2022 të papunë të regjistruar që kanë marrë pjesë në MATP (përveç aftësimit profesional) **ishin 2012 persona.** Nga ky numër, **762 ishin meshkuj** ndërsa **1250 ishin Gra.**<br><br>Nga viti 2018 deri në periudhën raportuese **18551 të papunë** të regjistruar që kanë marrë pjesë në MATP (përveç aftësimit profesional). Nga ky numër, **8,928 ishin meshkuj** dhe **9623 ishin femra**.<br><br>• **2018: 3,000 (1,805 ishin meshkuj dhe 1,195 ishin femra);**<br>• **2019: 4,611 të papunë** (**2,413 ishin meshkuj** dhe **2,198 ishin femra);**<br>• **2020: 5631 të papunë** ( **2,915 ishin femra** dhe **2,716 ishin meshkuj)**.<br>• **2021: 3297 persona.** Nga ky numër, **1232 ishin meshkuj** ndërsa **2065 ishin femra.**<br>• **2022: 2012 persona.** Nga ky numër, **762 ishin meshkuj** ndërsa **1250 ishin Gra.**<br><br>**Plotësisht e realizuar** |

[11] SIMP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4. Numri i të papunëve që ndërmjetësohen në punësim të rregullt[12] | 4022 (1550 F, 2742 M)[13] | 4164 (1643 F, 2521 M) | 4470 (1846 F, 2623 M) | Gjatë vitit 2022, numri i të papunëve që u ndërmjetësuan në punësim të rregullt ishte **4459**. Nga ky numër, **2313 ishin meshkuj** ndërsa **2146 ishin Gra**.<br><br>Në total nga viti 2018 deri me tani, numri i të papunëve që u ndërmjetësuan në punësim të rregullt ishte **16,668**. Nga ky numër, **9,460 ishin meshkuj** dhe **7,208 ishin femra**.<br><br>• **2018: 3,764** Nga ky numër, **2,193 ishin meshkuj** dhe **1,571 ishin femra**;<br>• 2019: **4,160**. Nga ky numër, **2,366 ishin meshkuj** dhe **1,794 ishin femra;**<br>• **2020: 1330**. Nga ky numër, **574 ishin femra** dhe **574 ishin meshkuj**;<br>• **2021: 2955**. Nga ky numër, **1456 ishin meshkuj** ndërsa **1499 ishin femra**.<br>• **2022: 4459.** Nga ky numër, **2313 ishin meshkuj,** ndërsa **2146 ishin Gra**.<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| | 5. Përqindja e përfituesve të MATP-se që janë të punësuar 6 muaj pas përfundimit të angazhimit në masat aktive të tregut të punës | Nuk ka të dhëna | Baza (2017) + 5 pikë të përqindjes | Baza (2017) + 15 pikë të përqindjes | Gjatë 2022: është publikuar raporti rreth efektivitetit të MATP-ve.<br><br>Hulumtimi për matjen e efektivitetit të MATP-ve ka filluar në K4 të vitit 2021, është përgatitur një draft raport për efektivitetin e MATP-ve, ndërsa publikimi do të bëhet në mars 2022.<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |

[12] Përqindjet e llogaritura nën supozimet në vijim: numri i punëkërkuesve mbetet i njëjtë.
[13] SIMP

| Objektivi specifik 1.3. | Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit | Baza | Caku 2020 | Caku 2022 | Realizimi i indikatorëve 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Ofrimi i shërbimeve cilësore të aftësimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës** | 1. Përqindja e të papunëve dhe punëkërkuesve të trajnuar në QAP-a | 6.6% (6,736)[14] | 10% | 15% | Numri i kandidatëve që kanë marr pjesë në trajnim gjatë vititi 2022 në Qendrat për Aftësim Profesional arrijnë shifrën prej 2,797 kandidatë.<br><br>Prej tyre: me aftësi të kufizuar 35, minoritete 118 dhe të kthyer 31.<br><br>Ndërsa në total nga viti 2018 deri me tani **21,490 punëkërkues** janë trajnuar në aftësim profesional në QAP-a.<br><br>• 2018: **5,497 punëkërkues** janë trajnuar në aftësim profesional në QAP-a;<br>• 2019, **6,607 punëkërkues**<br>• 2020: **3436 punëkërkues**<br>• 2021**: 3153 punëkeërkues**<br>• 2022**: 2797 punëkeërkues**<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |
| | 2. Përqindja e përfituesve nga trajnimi i kombinuar QAP dhe kompani | 1.4%[15]<br><br>95 | 5% | 15% | Gjatë vitit 2022 **përfitues** në trajnimin e kombinuar në QAP - Kompani ishin 62 persona.<br><br>Shprehur në total nga viti 2018 deri me tani, janë përfshirë **1,170 përfitues** në trajnimin e kombinuar në QAP dhe kompani.<br><br>• **2018: 162;**<br>• **2019: 322;**<br>• **2020 : 396**<br>• **2021: 228**<br>• **2022: 62** |

[14] MPMS, 2017, Puna dhe Punësimi 2016: Në vitin 2016, 6,636 të papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit, kanë marrë pjesë në trajnim në të trajnuar në QAP-a.
[15] MPMS, 2017, Puna dhe Punësimi 2016: Në vitin 2016, 95 të trajnuar në QAP-a, kanë ndjekur trajnimin edhe në kompani.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Plotësisht e realizuar** |
| | 3. Përqindja e të trajnuarve në QAP-a që janë punësuar, tre muaj pas përfundimit të trajnimit, në profesionin ku janë trajnuar | Nuk ka të dhëna | 10% | 30% | **Nuk ka të dhëna**. Kësisoj, indikatori është cilësuar si i **parealizuar.**<br><br>**Nuk është realizuar** |
| **Realizimi i të drejtave të punëtorëve**<br><br>**Objektivi Strategjik 2: Përmirësimi i kushteve të punës dhe zvogëlimi i punësimit joformal përmes fuqizimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe forcimit të dialogut social** | | | | | |
| **Objektivi specifik 2.1** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Përmirësimi i të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i standardeve minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, konform standardeve ndërkombëtare nëpërmjet avancimit të kornizës ligjore** | 1. Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore të aprovuara<br><br>(Nr i ligjeve dhe akte nënligjore të harmonizuara me legjislacionin e BE-së)<br><br>(Nr i ligjeve dhe akte nënligjore të miratuara për shëndetin dhe sigurinë) | 2 ligje pjesërisht të përafruara me legjislacionin e BE-së (Ligji i Punës dhe Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë); 7 rregullore të aprovuara nga siguria dhe shëndeti në punë | Draft i Ligjit të ri të Punës i përafruar plotësisht me legjislacionin e BE-së; 9 Rregullore nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë | Ligji i ri i Punës i përafruar plotësisht me legjislacionin e BE-se | **Gjatë vitit 2022**, është hartuar drafti i parë i Projektligjit të Punës, në të cilin janë transpozuar 17 direktiva të BE-se dhe është dërguar në Kabinetin e Ministrit për komente.<br><br>Është hartuar drafti i parë i Projektligjit të KES, i cili është dërguar në Kabinetin e Ministrit për komente.<br><br>Është hartuar drafti i parë i Projektligjit të Inspektoratit të Punës, i cili është dërguar në Kabinetin e Ministrit për komente.<br><br>Është hartuar drafti i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe është dërguar tek Zyra e Sekretarit të përgjithshëm të MFPT dhe në Departamentin Ligjor të MFPT-së, për procedim tutje. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (Nr i rregulloreve te miratuara në shëndetin dhe sigurinë në punë) | | | | Është transpozuar plotësisht Direktiva kornizë 89/391/EEC në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë.<br><br>Për Projektligjin e KES dhe Projektligjin për Inspektoratin e Punës nuk ka direktiva të BE-së.<br><br>**Gjatë vitit 2021 janë miratuar 2 Rregullore për SSHP**. Është miratuar Rregullore MPMS Nr 01/2021 per kualifikimin e personave pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, licencimin e kompanive te sherbimeve dhe trajnimeve per sigurine dhe shendetin ne pune. Rregullore MPMS Nr 02/2021 per vleresimin e riskut ne vendin e punes.<br><br>**17 direktiva të BE**-së janë transpozuar në Projektligjin e Punës dhe Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror.<br><br>Është hartuar draft **Koncept Dokumentit për Avancimin e Legjislacionit nga Fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, ndersa eshtë miratuar nga Qeveria me dhjetor 2020. Pas miratimit ne shkurt 2021 eshtë përgatitur Vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| | 2. Numri i direktivave të BE-së të transpozuara | 7 direktiva te transpozuara plotësisht | 12 direktiva te transpozuara plotësisht | 17 direktiva të transpozuara plotësisht në Ligjin e ri të Punës. | 17 direktiva të BE-së janë transpozuar në Projektligjin e Punës dhe Projektligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror.<br><br>1. Direktiva e Këshillit 91/533/EEC datë 14 Tetor 1991 mbi detyrimin e punëdhënësit për të njoftuar punonjësit mbi kushtet e zbatueshme në kontratë ose marrëdhënien e punës (OJ L 288, 18.10.1991);<br><br>2. Direktiva e Këshillit 92/85/EEC datë 19 Tetor 1992, mbi masat që inkurajojnë përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve shtatzëna dhe punonjësve të cilët gjatë këtyre ditëve kanë lindur fëmijë ose i |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kanë në gjidhënie (Direktiva e dhjetë individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC) (OJ L 348, 28.11.1992);<br><br>3. Direktiva e Këshillit 94/33/EC të datës 22 qershor 1994 mbi mbrojtjen e të rinjve në punë (OJ L 216, 20.8.1994);<br><br>4. Direktiva 96/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1996 për caktimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve (8 GZ L 18, 21.1.1997);<br><br>5. Direktiva 2014/67/EU të dt.15 maj 2014 mbi zbatimin e Direktivës 96/71/EC për caktimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm ("Rregullorja IMI');<br><br>6. Direktiva e Këshillit 97/81/EC të datës 15 Dhjetor 1997 lidhur me Marrëveshjen Kornizë për punë me kohë të pjesshme e lidhur nga UNICE, CEEP UNICE dhe EUTC (OJ L 14, 20.1.1998) e ndryshuar nga Direktiva e Këshillit 98/23/EC të datës 7 prill 1998 (OJ L 131, 5.5.1998);<br><br>7. Direktiva e Këshillit 98/59/EC të datës 20 Korrik 1998 mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me tepricat kolektive (OJ L 225, 12.8.98);<br><br>8. Direktiva e Këshillit 99/70/EC të datës 28 Qershor 1999 i përket marrëveshjes kornizë për punën me afat të caktuar" lidhur nga ETUC, UNICE dhe CEEP (OJ L 14, 20.01.1998);<br><br>9. Direktiva e Këshillit 2000/43/EC të datës 29 Qershor 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht origjinës etnike ose racore (OJ L 180, 19.07.2000);<br><br>10. Direktivën e Këshillit 2000/78/EC të datës 27 Nëntor 2000 që themelon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (OJ L 303, 2.12.2000); |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 11. Direktivën e Këshillit 2001/23/EC të datës 12 mars 2001 për përafrimin e Ligjit të Shteteve Anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, biznese apo pjesëve të ndërmarrjeve ose të bizneseve (3 OJ L 82, 0.6.2001);<br><br>12. Direktiva 2002/14/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2002 për themelimin e kornizës për informimin dhe negocimin e punonjësve në Komunitetin Evropian (OJ L 80, 23.3.2002);<br><br>13. Direktiva 2003/88/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 nëntor 2003 lidhur me aspekte të caktuara të organizimit të orarit të punës (OJ L 299, 18.11.2003);<br><br>14. Direktiva 2006/54 / EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (rifillimi) (OJ L204, 26.7 .2006, fq.23);<br><br>15. Direktiva 2008/94/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 lidhur me mbrojtjen e punëtorëve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre (verzion i kodifikuar) (OJ L 283, 28. 10. 2008);<br><br>16. Direktiva 2008/104/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 lidhur me aspekte të caktuara të organizimit të orarit të punës (OJ L 327, 5. 12. 2008);<br><br>17. Direktivën e Këshillit 2010/18/EU prej 8 Mars 2010 për zbatimin e marrëveshjes kornizë për të rishikuar lejen prindërorë të lidhur nga BUSINESSEUROPE, UEAPME, CEEP dhe ETUC dhe shfuqizimi i Direktivës 96/34/EC (OJ L BE 68, 18 Mars 2010).<br><br>1 Direktivë kornize e transpozuar plotesisht ne projektligjin e Sigurise dhe shendetit ne pune 89/391/EEC.<br><br>**Plotësisht e realizuar** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Përqindja e ankesave të punëtorëve të trajtuara | 456 ankesa te shqyrtuara nga Inspektorati i Punës | 100 ankesa te paraqitura dhe trajtuara nga Inspektorati i Punës | 150 ankesa te paraqitura dhe trajtuara nga Inspektorati i Punës | Gjatë vitit 2022, në Inspektoratin i Punës janë trajtuar **860 ankesa të parashtruara nga palët në procedurë**. Prej tyre 428 janë ta prashtruara nga sektori publik,sektori privat 420 ankesa dhe nga sektori publiko-privart janë 12 parashtrues te ankesës.<br><br>Bazuar nga ankesat e parashtruara,numri me i madh i tyre kemi te bajmë me punësim pa kontratë pune, mohimi i pushimit vjetor, moskompenzim i punës jashtë orarit te rregullt, diteve te vikendit dhe festave zyrtare, nderprerja e njëanshme e maredhenies se punës, mos krijimi i kushteve te pershtatshme dhe te sigurta per punë.<br><br>Gjate vitit 2022 në kuadër te Inspektoratit të Punës në organin e shkallës së dytë janë trajtuar **818 ankesa të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë.**<br><br>**Gjithesej janë trajtuar 1678 ankesa të palët.**<br><br>Gjatë vitit 2021 janë realizuar **5155 inspektime sipas ankesës së palëve.** Në shkallën e dytë janë trajtuar **1633** ankesa të palëve kundër vendimeve te shkallës së parë prej të cilave janë 83 ankesa janë refuzuar si te pa baza 798 ankesa janë aprovuar, 161 janë kthyer në rishqyrtim në shkallën e parë dhe 3 palëve u është aprovuar pjesërisht ankesa e palëve. Shkeljet që janë bërë punëdhënësi-it ndaj punëtoreve kemi këto raste : 1959 paga jubilare, shujta 1362, ndërpreja marrëdhënies së punës 142, puna gjatë vikendeve 1027, jashtë orarit të punës 344, pushime vjetore 332, kompenzimi i pagave 781, puntore me kontrata të punës por të pa lajmëruar ne ATK 433, ndërsa 709 punëtorë pa kontrata dhe te paregjistruar ne ATK.<br><br>Gjatë 2018, janë realizuar **1,742 inspektime** sipas ankesës së palëve, të cilat kanë konsideruar që po u shkelën të drejtat e tyre juridike nga shkalla e parë, si dhe **850 ankesa** janë shqyrtuar nga shkalla e dytë, ankesa këto të drejtuara kundër vendimit të shkallës së parë.<br><br>Gjatë 2019, janë realizuar **mbi 1500 inspektime** sipas ankesës së palëve, të cilat kanë konsideruar që po u shkelën të drejtat e tyre juridike nga shkalla e parë, si dhe **1432 ankesa** janë shqyrtuar nga shkalla e dytë, ankesa këto të |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | drejtuara kundër vendimit të shkallës së parë. Për më tepër, janë nxjerr edhe mijëra vendime sipas ankesës së palëve, për të cilat nuk ka pasur nevojë që të bëhet inspektim.<br><br>Gjatëv itit 2020 janë trajtuar **10432 ankesa te palëve**, me pretendimin se u cenohen te drejtat nga maredhenja e punes, ndersa ne shkallen e dytë të IP-së janë nxjerr 506 vendime.<br><br>**Në total numri nr i ankesave të trajtuara nga IP është 19, 547.**<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| **Objektivi specifik 2.2** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Përforcimi i mekanizmave mbikëqyrës për zvogëlimin e punësimit joformal** | 1. Norma e zvogëlimit të punësimit joformal për çdo vit, shprehur në përqindje | 15%[16] | 10%, çdo vit 5% | 8% | Sipas Bankës Botërore, punësimi informal llogaritet të jetë 15% në vitin 2017.<br><br>**Ndërsa sipas AFP për 2021, 8.6%** e të punësuarave punonin pa kontratë.<br><br>Shkallë më e lartë e punës joformale është gjetur nga Studimi i Shfrytëzimit të Kohës, të mbështetur nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC), e realizuar në vitin 2017. Sipas këtij studimi, në vitin 2017, 40.8% e punëtorëve nuk kishin kontratë pune, dukshëm më e lartë sesa norma e raportuar nga AFP.<br><br>**Pjesërisht i realizuar** |

[16] ASK

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Përqindja e ngritjes së numrit të inspektimeve për çdo vit | 7,285 inspektime | Rritet për 10% numri i shqyrtimit të ankesave | Rritet për 10% numri i shqyrtimit të ankesave | **Gjatë vitit 2022, IP-ja ka kryer 6316 inspektime** (të planifikuara 3323, të përsëritura 1602, të jashtëzakonshme (rastësore) 46, Inspektime për shkak të aksidenteve në punë 404, inspektimet në bashkëpunim me institucionet tjera të mbikëqyrjes 81 dhe **inspektimet sipas ankesës së palëve 860. Në shkallën e dytë janë trajtuar 818 ankesa t**ë palëve kundër vendime te shkallës.<br><br>Inspektorati i Punës ka arritur që gjatë vitit 2022,të legalizojë punën e rreth 640 të punësuarave të cilët kanë punuar te padeklaruar qoftë duke mos pasur kontratë fare apo edhe duke mos qenë i deklaruar për pagesën e kontributeve.<br><br>Në vitin 2022, IP ka inspektuar mbi 51058 t'punësua, 32698 meshkuj, 18360 femra, duke përfshirë edhe shtetasit e huaj që punojnë në Republikën e Kosovës.<br><br>Për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, IP ka shqiptuar rreth 359 gjoba si masa ndëshkimore,ndaj punëshënësve te cilët kanë vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore nga marëdhënia e punës,siguria e shendeti në punë.<br><br>Gjatë vitit 2021 IP-ja ka kryer **10162 inspektime në total**:( të planifikuara 3022, të përsëritura1601, të jashtëzakonshme (rastësore) 38, Inspektime për shkak të aksidenteve në punë 238, inspektimet në bashkëpunim me institucionet tjera të mbikëqyrjes 108 dhe **inspektimet sipas ankesës së palëve 5155**.Në shkallën e dytë janë trajtuar 1633 ankesa të palëve kundër vendime te shkallës së parë prej të cilave janë 83 ankesa janë refuzuar si te pa baza 798 ankesa janë aprovuar,161 janë kthyer në rishqyrtim në shkallën e parë dhe 3 palëve u është aprovuar pjesërisht ankesa e palëve. Shkeljet që janë bërë punëdhënësi-it ndaj punëtoreve kemi këto raste : 1959 paga jubilare, shujta 1362, ndërpreja marrëdhënies së punës 142, puna gjatë vikendeve 1027, jashtë orarit të punës 344, pushime vjetore 332, kompenzimi i pagave 781, puntore me kontrata të punës por të pa lajmëruar ne ATK 433, ndërsa 709 punëtorë pa kontrata dhe te paregjistruar ne ATK.<br><br>**Inspektorati i Punës ka arritur që gjatë vitit 2021,të legalizojë punën e rreth 345 të punësuarave të cilët kanë punuar te padeklaruar** qoftë duke mos pasur kontratë fare apo edhe duke mos qenë i deklaruar për pagesën e kontributeve. Gjithashtu në 29 raste kur IP ka hasur që subjektet që kanë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | pasur të punësuar punëtorë por që si të tilla nuk kanë qenë të legalizuara dhe nuk kanë pasur licencë për zhvillim të punës, përmes mekanizmit të lajmërimit dhe formalizmit të punës së punëtorëve ka detyruar subjektet që të legalizojnë aktivitetin e tyre.<br><br>Në vitin 2021 **IP ka inspektuar mbi 38035 t'punësua**, 26434 meshkuj,11636 femra, duke përfshirë edhe shtetasit e huaj që punojnë në Republikën e Kosovës.<br><br>35 Punëtor të huaj 35,6 meshkuj dhe 29 femra.<br><br>Për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, **IP ka shqiptuar rreth 281 gjoba si masa ndëshkimore.**<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| **Objektivi specifik 2.3** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Zhvillimi dhe përforcimi i dialogut me partnerët social, në veçanti, dialogu social me organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, nëpërmjet zhvillimit të strukturave dhe sistemit të punës së KES-it** | 1. Numri i rekomandimeve të bëra nga KES-i dhe komisioneve profesionale të tij | 10 rekomandime | 7 rekomandime (3 në vitin 2017, 4 në vitin 2018) | 12 rekomandime<br><br>(4 në vitin 2019, 4 në vitin 2020, 4 në vitin 2021) | Komisionet profesionale të KES, pas funksionalizimit, kanë bërë në total **katër (4) rekomandime: për pagën minimale;** për **marrëveshjen e përgjithshme kolektive;** për **vendosjen e kodit për asistentë/ nxënes me nevoja të veçanta;** si dhe për **koston e marrëveshjes së përgjithshme kolektive**.<br><br>Gjithashtu gjatë vitit 2020 pas formimit të QK se re anetaret e KES përseri kanë kërkuar mandatimin e komisioneve profesionale te KES për të negociuar dhe hartuar marrëveshjen e re kolektive dhe për të dale më rekomandimin për pagen minimale, si dhe koston e marveshjes kolektive<br><br>Gjate vitit 2021 nuk ka pasur rekomandime nga KES.<br><br>**Gjatë vitit 2022**, Komisioni ad-hoc i themeluar nga KES, ka nxjerrur rekomandimin për hartimin e planit të punës së KES, i cili është miratuar nga |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | KES. Komisioni profesional për legjislacion trepalësh ka nxjerrur rekomandimin për Marrëveshjen e përgjithshme Kolektive dhe ka prezantuar draftin e Marrëveshjes në takim të KES-it, e cila nuk ka arritur ende të miratohet nga KES. Komisioni profesional për paga, çmime dhe pensione ka nxjerrur rekomandim për pagën minimale.<br><br>**<u>Pjesërisht e realizuar</u>** |
| | 2. Numri i marrëveshjeve kolektive, të nënshkruara, në nivel sektorial dhe të ndërmarrjes | 7 marrëveshje të nënshkruara | 1 marrëveshje e re e përgjithshme kolektive; 2 marrëveshje të reja sektoriale; 2 marrëveshje të reja në nivel të ndërmarrjes | 2 marrëveshje të reja sektoriale; 4 marrëveshje të reja në nivel të ndërmarrjes | **Gjate 2022**, në nivelin nacional, është hartuar **marrëveshja e përgjithshme kolektive**, e cila nuk ka arritur të nënshkruhet, ndërsa në nivel sektorial dhe të ndërmarrjes, gjatë periudhës raportuese nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje kolektive.<br><br>**<u>Pjesërisht e realizuar</u>** |
| | 3. Numri i partnerëve socialë të përfshirë në KES | 3 partnerë me nga 5 anëtar secili | 3 partnerë socialë, me përfshirje më të gjerë të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve | Tre partnerë social, me përfshirje më të gjerë të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve | Në mandatin aktual të KES, kemi të përfshirë **<u>dy (2) organizata të punëdhënësve</u>**, **<u>një (1) të punëmarrësve,</u>** si dhe **<u>Qeveria</u>**.<br><br>**<u>Plotësisht e realizuar</u>** |
| | 4. Numri i partnerëve anëtarë të përfshirë në KES | 15 | 30 | 45 | KES ka **<u>15 anëtarë</u>**.<br><br>Nga Organizatat e punëdhënësve në KES përfaqësohet Oda Ekonomike e Kosovës me tre anëtar dhe Aleanca Kosovare e Biznesit me dy anëtar. Nga organizatat e punëmarrësve në KES përfaqësohet Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës me pesë anëtar dhe pesë anëtaret tjerë janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Nuk është realizuar** |
| **Objektivi strategjik 3: Rritja e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë së mbrojtjes sociale, arritjes së barazisë gjinore dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve sociale e familjare, me përqendrim të veçantë në grupet e cenueshme** | | | | | |
| **Objektivi specifik 3.1** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Zvogëlimi i varfërisë dhe përjashtimit social duke ofruar shërbime dhe përfitime të integruara për gratë dhe burrat në nevojë sociale dhe për grupet tjera të cenueshme** | 1. Shkalla e varfërisë | 17.6%[17] | 15% | 13% | **Gjatë vitit 2022**, lidhur me të dhënat e varfërisë në Kosve, aktualisht te dhëna zyrtare mbesin te dhënat e hulumtimit vitti 2017.<br><br>**Shkalla e varfërisë vazhdon të jetë e lartë, rreth 21 % të popullsisë që llogaritet të jetojë në varfëri në vitin 2019**. Varfëria në zonat rurale është e lartë, ndërsa mbi 40 % e popullsisë rurale është e papunë. Në vitin 2017, niveli i varfërisë në mesin e ekonomive familjare me tre ose më shumë fëmijë ishte 2.5 herë më shumë se niveli i varfërisë tek familjet pa fëmijë. Indeksi i Kapitalit Njerëzor (HCI) tregon se një fëmijë i lindur sot në Kosovë do të jetë 56 % produktiv kur të rritet krahasuar me të njëjtin fëmijë nëse do të gëzonte arsim të plotë dhe shëndet të mirë.<br><br>Ndersa sa i përket numrit te familjeve që përfitojnë ndihmë sociale ato ndryshojnë nga muaji në muaj dhe bazuar në muajin janar 2022 numri i përfituesve ishte 25,933 me numër të anëtarve 102,845, ne vlerë prej 3,272,980.00 euro krahasuar me muajin dhjetor 2022 ku numri i përfituesve |

[17] Bazuar në kufirin e varfërisë (2015): 1.82eur në ditë për ekuivalentin për të rritur. Llogaritur me të dhënat e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. KAS. (Prill, 2017). Marrë nga: http://ask.rks-gov.net/media/3186/stat-e-varferise-2012-2015.pdf

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ishte 22,980 me numër te anetarve 90,806 ne vlere prej 2,911,070.00€. Duke u bazuar në këto të dhëna shihet një renje e numrit të familjeve ne ndihmë sociale por kjo nuk do të thot se është një tregues i varfëris në Kosovë.<br><br>**Nuk është realizuar** |
| | 2. Shkalla e mbulueshmërisë së familjeve të varfëra nga Skema e Ndihmës Sociale | 45%[18] | 50% | 70% | **Gjatë vitit 2022**, numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale ka ndryshuar nga muaji në muaj e sidomos pas shfuqizimit te vendimit 17/2021 të plotësuar dhe ndryshuar duke obliguar kështu të gjithë përfituesit e skemave pensionale dhe sociale te ri-fillojnë paraqitjen ne zyrat përkatëse dhe ri aplikimi të fillojmë me procedura të rregullta bazuar në ligjet e SNS-se. Kështu që ne dhjetor 2022 kanë përfituar rreth 22,980 familje, me 90,806 anëtarë, në shumë mujore 2,911,070.00€.<br><br>**Shkalla e mbulushmerisë llogaritet te jetë prej 50% e familjeve të varfra në Kosovë**.<br><br>Kundrejt cakut prej 70% për vitin 2022, indikatori cilësohet si i realizuar për vitin 2021.<br><br>**Pjesësisht e realizuar** |
| | 3. Numri i personave që dalin nga varfëria | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Nuk ka të dhëna | Megjithatë, programet e përfitimeve nga të gjitha skemat dhe shërbimet mbulojnë **283,297 familje/individë, apo 15.56 % të popullsisë.**<br><br>Kësisoj, mund të supozohet se kjo skemë ndihmon të paktën disa nga përfituesit të dalin nga varfëria. Mbi këtë bazë (e cila detyrimisht nuk është gjithaq objektive), indikatori cilësohet si "pjesërisht i realizuar". |

[18] Llogaritur duke pjesëtuar numrin e përfituesve të Skemës së Ndihmës Sociale (25,943 familje në vitin 2015) – (10% që supozohet se janë përfituese por nuk janë familje të varfëra) me numrin total të familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme. Numri i familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme është llogaritur duke shumëzuar shkallën e varfërisë së skajshme për vitin 2015 (5.2%) me numrin total të ekonomive familjare në Kosovë në bazë të Regjistrimit të Popullsisë (2011), përafërsisht 295,000 familje. Përderisa të dhënat mbi shkallën e varfërisë së skajshme janë marrë nga raportit i fundit i Varfërisë në Konsum 2012-2015 (KAS, 2017), të dhënat për numrin e përfituesve të Skemës së Ndihmës Sociale janë marrë nga të dhënat administrative të DPSF-së.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Nuk ka të dhëna<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |
| **Objektivi specifik 3.2.** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Zhvillimi i mekanizmave për financim në komuna dhe krijimi i infrastrukturës fizike për qëndrueshmëri të ofrimit të shërbimeve sociale nga sektori publik dhe joqeveritar** | 1. Zbatimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale | Shërbimet sociale në nivel lokal financohen nga Granti i Përgjithshëm[19] | Shërbimet sociale në nivel lokal financohen nga Granti Specifik për Shërbime Sociale | Shërbimet sociale në nivel lokal financohen nga Granti Specifik për Shërbime Sociale | **Gjatë vitit 2022**, me mbështetje të UNICEF-it është përgaditur një analizë dhe dokument i nevojave për financim të shërbimeve sociale që planifikohet të diskutohet me institucionet e nivelit qendror dhe lokal dhe do të prezantohet më pas në Komisionin e Granteve në vitin 2023.<br><br>Bazuar në Koncept Dokumentin e miratuar, gjatë vitit 2019 është hartuar Ligji i ri për Financat e Pushtetit Lokal ku është paraparë krijimi i Grantit Specifik për Shërbime Sociale. Projektligji ka kaluar fazën e konsultimeve publike, megjithatë nuk është miratuar ende nga Qeveria dhe Kuvendi. Në kuadër të këtij Projektligji është planifikuar krijimi i Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale, përmes së cilit grant do të krijohen mekanizmat dhe kriteret e qarta të financimit për shërbime sociale për komunat dhe sektorin joqeveritar.<br><br>Janë finalizuar propozimet e MPMS per Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale, të cilat propozime i janë dërguar Ministrisë së Financave, si dhe hartimi i dokumentit për implikime buxhetore dhe shpërndarjen e Grantit të Veçantë, i cili dokument do të jetë bazë për hartimin e Udhëzimit Administrativ Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale, siç është planifikuar me Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal.<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |

[19] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës dhe buxhetet e komunave

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Numri dhe lloji i shërbimeve sociale për të cilat është llogaritur kostoja për njësi (klient) | 5[20] | 10 | 20 | **Gjatë vitit 2022**, shërbimet për Personat e Moshuar dhe Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore , pa kujdes familjar në strehim rezidencial ofrohen 24 orë-duke përfshirë: strehimin ,akomodimin , ushqimin , veshmbathjen, shërbimet shëndetësore, dhe të gjitha shërbimet e tjera të vlerësuara si të nevojshme për personat me aftësi të kufizuara, prapambetje mendore dhe personat e moshuar pa kujdes familjar në strehim ne SHPMPF, ISSH dhe SHBK. Nga këto shërbime rezidenciale kanë përfituar mbi 270 rezidentë/klientë të vendosur në këto institucione.<br><br>Sa i përket shërbimeve rezidenciale , këto shërbime janë të kostuara, vlera mujore është rreth 1000 euro për një person për një muaj.<br><br>Kostoja e sherbimeve eshte llogaritur per 6 sherbime,<br><br>- Sherbimi per qendrat rezidenciale<br>- Sherbimi per qendrat ditore<br>- Sherbimi per viktimat e dhunes<br>- Sherbimi per viktimat e trafikimit<br>- Sherbimi per persona me aftesi te kufizuara<br>- Sherbimi per persona te moshuar<br><br>Me mbështetjen e projekti të BE-së, të zbatuar nga Save the Children, është **hartuar dokumenti** për disa kosto për njësi për shërbime sociale. Në kuadër të këtij dokumenti **janë indentifikuar disa kosto për njësi bazuar në shpenzimet** që ka një Qendër Rezidenciale dhe Qendrat Ditore për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës, trafikimit, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuar. Ish MPMS raporton se ka koston e shpenzimeve për disa shërbimeve, **por nuk është specifikuar numri.**<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |

[20] Të dhënat administrative të DPSF-së

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3. Numri i qendrave rezidenciale dhe ditore të ndërtuara për ofrimin e shërbimeve sociale | 10[21] | 15 | 20 | **Në vitin 2022**: Numri i qendrave rezidenciale për ofrimin e shërbimeve per Personave te Moshuar dhe me Aftesi të Kufizuara është 15 –të.<br><br>Dy institucionet SHPMPF dhe ISSH , kanë në strehim numër më të madh të strehuarve krahasuar me 13 Shtëpi me bazë në Komunitet.<br><br>Në vitin 2021 është funksionalizuar Shtëpia me bazë në Komunitet për të Moshuar në Novobërd, kapaciteti strehues 11 –të raste.<br><br>Ndërkaq në Prizren , është përfunduar procesi i ndërtimit dhe mobilimit i Shtëpisë për Persona të Moshuar.<br><br>Funksionalizimi pritet në Mars 2023. Kapaciteti strehues ë shtë 30 raste .<br><br>Janë duke u ofruar shërbimet rezidenciale në dy institucione si në ISSH dhe në SHPMPF në Prishtinë dhe në 13 Shtëpi me bazë në Komunitet, ku ofrohen shërbime rezidenciale 24 orë Personat me Aftësi të Kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor si dhe Personat e Moshuar pa Përkujdesje Familjare.<br><br>Aktualisht numri i Personave të Moshuar pa Kujdes Familjar në strehim rezidencial në SHPMPF dhe 4 SHBK është 116.<br><br>Numri i personave me aftësi të kufizuar ngecje mendore në strehim rezidencial në ISSH dhe 9 SHBK është 154.<br><br>Gjithsej 270 Persona te Moshuar dhe me Aftesi të Kufizuar Mendore, që u ofrohet forma e mbrojtjes / strehimi rezidencial .<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |

[21] Të dhënat administrative të DPSF-së

| Objektivi specifik 3.3. | Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit | Baza | Caku 2020 | Caku 2022 | Realizimi i indikatorëve 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Rritja e vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve sociale përmes zhvillimit të formave alternative dhe inovative për promovimin e përfshirjes sociale dhe licencimit e monitorimit të të gjithë ofruesve** | 1. Numri i ofrueseve joqeveritarë të licencuar | 20[22] | 50 | 100 | **Gjatë vitit 2022 janë pranuar nëntëmbëdhjetë (19**), kërkesa nga Organizatat Joqeveritare dhe Subjekteve tjera Juridike Private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Komisioni ka shqyrtuar dhe vlersuar shtatëmbëdhjetë (**17**) kërkesa,pesëmbëdhjetë (**15**) kërkesa kanë marr vendim aprovus dhe licencuar ndërsa dy (**2**) kërkesa janë refuzuar dhe dy kërkesa janë në shqyrtim.<br><br>**Gjatë 2021 janë pranuar dyzetë e nëntë (49**) kërkesa për licencim të parashtruara nga Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) dhe nga subjektet e tjera juridike që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare. Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, ku dyzetë e tetë (**48) kërkesa janë aprovuar ndërsa një (1) kërkesë është refuzuar.**<br><br>• Gjatë vitit 2018, u licensuan **26 subjekte**<br>• Gjatë vitit 2019, Departamenti për Politika Sociale dhe Familje ka **licencuar 41 subjekte** juridike/organizata joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.<br>• Gjatë vitit 2020, Departamenti për Politika Sociale dhe Familje ka **licencuar 6 subjekte** juridike/organizata joqeveritare që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare<br>• Gjatë vitit 2021 janë licencuar **48 OJQ që ofrojnë shërbime sociale dhe familajre**<br>• Gjatë vitit 2022 janë licencuar **15 OJQ që ofrojnë shërbime sociale dhe familajre**<br><br>**Kësisoj konsiderohet indikator i realizuar** |

[22] Të dhënat administrative të DPSF-së

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Plotësisht e realizuar** |
| | 2. Numri i ndërmarrjeve sociale të regjistruara | 10[23] | 50 | 100 | Është **aprovuar Ligji për Ndërmarrjet Sociale** në nëntor të vitit 2018. Aktet nënligjore janë hartuar në 2019, por ende **nuk është filluar me regjistrimin** e këtyre ndërmarrjeve. Me projekt Rregulloren e re të MFPT është paraparë te themelohet Divizioni i Ndërmarrjeve sociale. Andaj, pa u funksionalizuar Divizioni i Ndërmarrjeve Sociale, nuk mund të filloj procesi i regjistrimi dhe licencimit të tyre.<br><br>**Nuk është realizuar** |
| | 3. Numri i partneriteteve lokale (komunë-sektor joqeveritar-komunitet) të themeluara | 5[24] | 15 | 30 | Ende nuk ka një iniciativë dhe gadishmëri nga nivelet komunale për inicimin e themelimit të partneriteteve komunale.<br><br>**Nuk është realizuar** |
| **Objektivi specifik 3.4.** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare përmes ngritjes së kapaciteteve njerëzore të ofruesve publik dhe jo-qeveritar** | 1. Numri i standardeve të aprovuara të profesionit | 3[25] | 5 | 8 | Gjatë vitit 2021 është punuar në rishikimin e formave, udhëzuesve dhe standardeve. Eshtë realizuar një raport për Standardet minimale të kategorisë së "Fëmijëve të përfshirë në Punë të rënda dhe të rrezikshme " dhe së fundmi Raportin për Standardet Minimale **( gjithsej 10) të hartuara**.<br><br>Gjatë 2018, është raportuar për aprovimin e **23 standardeve** të shërbimeve sociale dhe familjare. |

[23] Të dhënat administrative të DPSF-së
[24] Të dhënat administrative të DPSF-së
[25] Të dhënat administrative të DPSF-së

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Gjatë 2019, raportoi aprovimin e **3 standardeve** të shërbimeve sociale dhe familjare:<br><br>Në vitin 2021, është raportuar për hartimin e **10 standardeve**<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| | 2. Numri i moduleve të validuara të trajnimit për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare | 5[26] | 7 | 10 | **Gjatë vitit 2022**, është dorëzuar kërkesa për akreditim të KPSHSF dhe validim të moduleve të trajnimit në Autoritetin. Gjithashtu ekspertet e angazhuar nga AKK, kanë vizituar dhe intervistuar zyrtarët dhe trajneret e KPSHSF, dhe tani jemi në pritje të përgjegjës përfundimtare lidhur me procesin e akreditimit.<br><br>Gjatë vitit 2021, kanë përfunduar pothuajse të gjitha përgatitjet, kështu që KPSHSF, gjatë muajit Mars ose Prill, pritet të aplikoje në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve për akreditim dhe validim të moduleve të trajnimit për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.<br><br>**Nuk është realizuar** |
| | 3. Numri i punëtorëve socialë nga sektori publik dhe joqeveritar të trajnuar | 150[27] | 500 | 1,000 | **Gjatë 2022**, **janë trajnuar mbi 60 trajner të shërbimeve sociale familjare**, të cilët do të zhvillojnë materialet/modulet dhe do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.<br><br>Gjatë 2021, **janë trajnuar mbi 32 trajner të shërbimeve sociale familjare**, të cilët do të zhvillojnë materialet/modulet dhe do të ofrojnë trajnime për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare.<br><br>Gjatë 2020, janë trajnuarmbi **200 ofrues** të shërbimeve sociale familjare, punëtorë socialë të tre niveleve nga sektori qeveritar dhe joqeveritar.<br><br>Gjatë 2018, janë trajnuar **160 ofrues** të shërbimeve sociale familjare, punëtorë socialë të të tre niveleve nga sektori qeveritar dhe joqeveritar. |

[26] Të dhënat administrative të DPSF-së
[27] Të dhënat administrative të DPSF-së

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Pjesërisht e realizuar** |

| **Objektivi Strategjik 4: Realizimi i të drejtave në përfitime për pensionistët dhe pensionistet dhe kategoritë e dalura nga lufta përmes zhvillimit të sistemit të qëndrueshëm pensional, harmonizimit të kornizës ligjore dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe teknologjike** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi specifik 4.1** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
| **Rishikimi, harmonizimi, dhe zbatimi i plotë i kornizës ligjore për realizimin e së drejtës në pensione dhe beneficionve** | 1. Numri i Skemave Pensionale të menaxhuara nga DP dhe DFDIL të përfshira në Ligjin për Pensionet e Financuara nga Shteti | 6 skema pensionale[28] | Të gjitha skemat në zbatim të përfshira në ligj | N/A | **Gjashtë (6)** skema pensonale:<br>1. Pensioni Bazë<br>2. Pensioni Kontributpagues<br>3. Pensioni i PPAK-së<br>4. Pensioni i Parakohshëm Trepça<br>5. Pensioni Invalidor i Punës<br>6. Pensioni Familjar<br>**Plotësisht e realizuar** |

[28] Pensioni bazik i moshës, Pensioni kontribut pagues i moshës, Pensioni i paaftësisë së përhershme, Pensioni i parakohshëm (për minatorët e kompleksit Trepça dhe minatorët e punësuar në minierat tjera të Kosovës), Pensioni invalidor i punës, Pensioni familjar. Ligji nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Numri i kërkesave për skema pensionale të reja të shqyrtuara, sipas skemave | Numri i kërkesave, sipas skemave pensionale[29]<br>**2.** Pensioni Invalidor i Punës: 0 përfitues<br>**3.** Pensioni Familjar: 0 përfitues<br>**4.** Kompensimi për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë: 0 përfitues<br>**5.** Kompensimi për ish-deputetët e Kaçanikut | Numri i kërkesave për skemat pensionale ((1)-(6)), më i lartë se 0 | Numri i kërkesave për skemën (7), më i lartë se 0 | **Gjatë 2022, numri i kërkesave, sipas skemave pensionale është:**<br>• Pensioni Invalidor i Punës:**2**;<br>• **Pensioni Familjar: 389;**<br>• **Kompensimi për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë: 649**;<br>• Kompenzimi për Punëtoret e arsimit nga viti shkollor 1990/1991 deri në vitin 1998/99 **1033;**<br>• Pension baze **16837;**<br>• Pension kontributiv **2908;**<br>• **PPAK 5279;**<br>• FSK **81;**<br>• TMK **69;**<br>• **Trepça 6;**<br>• **Te verbër 150**.<br>Ndërsa gjatë 2021, numri i kërkesave, sipas skemave pensionale është:<br>• Pensioni Invalidor i Punës:**10**;<br>• **Pensioni Familjar: 558;**<br>• **Kompensimi për Personat Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë: 633**;<br>• Kompenzimi për Punëtoret e arsimit nga viti shkollor 1990/1991 deri në vitin 1998/99 **1159;**<br>• Pension baze **18012;**<br>• Pension kontributiv **3585;**<br>• **PPAK 5108;**<br>• FSK **43;**<br>• TMK **69;**<br>• **Trepça 10;**<br>• **Te verbër 103**.<br>**Shënim: gjatë 2022,** shprehur në mënyrë kumulative komisionet mjekësore kanë shqyrtuar në shkallën e parë 17156 raste, në shkallë e dytë 2205 dhe në shkallën |

[29] Të dhënat administrative nga DP.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | e tretë 203 raste nga skemat pensionale: PPAK, paraplegjik dhe tetraplegjik, per personat e verbër, pensionet e parakohshme “Trepça”, pension invalidor i punës sipas marrëveshjeve për sigurime sociale. Sa i përket skemave që menaxhohen nga DPSF janë trajtuar 12470 në shkallën e parë, ndërsa në shkallën e dytë 1058; ndërsa në DFDIL janë trajtuar 87 raste në shkallën e parë, 37 në shkallën e dytë dhe 40 në shkallën e tretë.<br><br>**Plotësisht e realizuar** |
| **Objektivi specifik 4.2** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Raportimi i indikatorëve 2022** |
| **Realizimi i së drejtës në pensione dhe beneficione për kategoritë e dalura nga lufta përmes zbatimit të plotë të kornizës ligjore dhe rifunksionalizimit të mekanizmave administrative** | 1. Numri i kërkesave të reja të pranuara, sipas skemave [30] | Zero (që nga viti 2011, përveç skemës se të zhdukurve) | Numri i kërkesave të reja të pranuara, sipas skemave është më i lartë se 0 | Numri i kërkesave të reja të pranuara, sipas skemave është më i lartë se 0 | • **2018:** Janë pranuar **624 lëndë familjare**; **2,577 lëndë te invalidëve**; dhe **2,212 lëndë të veteranëve**.<br>• **2019:** Janë pranuar **577 lendë të veteranëve**; **135 lendë familjare**; **135 lendë të invalidëve**; dhe **439 lendë të viktimave të dhunës seksuale** të cilat edhe janë procesuar.<br>• **2020:** Janë pranuar **477 lendë të veteranëve**; **81 lendë familjare**; **25 lendë të invalidëve**; dhe **276 lendë të viktimave të dhunës seksuale** të cilat edhe janë procesuar.<br>• **2021**: Janë pranuar **671 lendë të veteranëve**; **100 lendë familjare**; 13 lëndë të invalideve dhe **141 lendë të viktimave të dhunës seksuale** të cilat edhe janë procesuar.<br>• **2022**: Janë pranuar **197 lendë të veteranëve; 98 lendë familjare dhe invalideve dhe 342 lendë të viktimave të dhunës seksuale** të cilat edhe janë procesuar.<br><br>**Plotësisht e realizuar** |

[30] Të dhënat administrative nga DFDIL

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Numri i vlerësimeve të gjendjes së përfituesve aktualë dhe rasteve të reja nga Komisioni Mjekësor për Skemën e Invalidëve të Luftës dhe Skemën e Invalidëve Civil të Luftës[31] | N/A | 11,500 (6,500 përfitues aktualë dhe të gjithë aplikuesit e rinj + aplikuesit e rinj 5,000) | N/A | • 2018: janë mbajtur **109 seanca të komisionit mjekësor** të shkallës së parë, ku janë shqyrtuar **2,725 lëndë**; dhe janë mbajtur **14 seanca të shkallës së dytë,** ku janë shqyrtuar **350 lëndë**.<br>• 2019: Janë mbajtur **35 seanca të komisionit mjekësor** të shkallës së parë ku janë shqyrtuar **830 lendë** dhe **34 seanca të shkallës së dytë ku janë shqyrtuar 820 lendë**.<br>• 2020: Janë mbajtur 16 seanca të komisionit mjekësor të shkallës së parë ku janë shqyrtuar 305 lendë te Invalidëve te Luftes dhe 44 lende te Invalideve Civil dhe 8 seanca të shkallës së dytë ku janë shqyrtuar 107 lende te invalideve te luftes dhe 25 lendë te Invalideve Civil.<br>• 2021, Janë mbajtur 10 seanca të komisionit mjekësor të shkallës së parë ku janë shqyrtuar 168 lendë të Invalidëve të Luftës dhe Invalideve Civil si dhe 6 seanca të shkallës së dytë ku janë shqyrtuar 111 lëndë të invalideve të luftes dhe Invalideve Civil.<br>• **2022,** Janë mbajtur 2 seanca të komisionit mjekësor të shkallës së parë ku janë shqyrtuar 93 lendë të Invalidëve të Luftës dhe Invalideve Civil si dhe 6 seanca të shkallës së dytë ku janë shqyrtuar 98 lëndë të invalideve të luftes dhe Invalideve Civil.<br><br>**Pjesërisht e realizuar** |
| | 3. Numri i përfituesve nga Skema e Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës32 | Zero (0) | 20,000 përfitues | N/A | • **2018**, numri i përfituesve të Skemës së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, ka qenë **167,** dhe janë shpenzuar **€268,875.**<br>• **2019**, **numri i përfituesve** të Skemës së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës **ka qenë 606.**<br>• **2020**, **numri i përfituesve** të Skemës së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës **ka qenë 882 (**te gjtha rastet e paraqitura me status të viktimes janë futur ne pagesë)<br>• **2021, numri i përfituesve** të Skemës së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës ka qenë 1,023. |

[31] Të dhënat administrative nga DFDIl
[32] Të dhënat administrative nga DFDIL

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | • **2022, <u>numri i përfituesve</u>** të Skemës së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës ka qenë 342.<br><br>**<u>Pjesërisht e realizuar</u>** |
| **Objektivi specifik 4.3** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Raportimi i indikatorëve 2022** |
| **Realizimi i së drejtës në pensione të jashtme përmes avancimit dhe koordinimit të sigurimeve sociale me zbatimin e marrëveshjeve bilaterale ekzistuese dhe negocimin e marrëveshjeve të reja** | 1. Numri i marrëveshjeve të reja bilaterale të nënshkruara[33] | 2 marrëveshje (Maqedoni, Mali i Zi) | 4 marrëveshje | 7 marrëveshje | **Gjatë vitit 2022: Është nënshkruar Marrëveshja Administrative me Republiken e Shqiperise,** në fushen e sigurimeve shoqërore. Janë ndërmarrë hapat e nevojshem per vazhdimin e negociatave lidhur me Marrëveshjen për Sigurime Sociale me Republiken e Austrise. Janë ndermarrë hapat per fillimin e negociatave per lidhjen Marrëveshjes për Sigurime Sociale me Republiken e Kroacisë.<br><br>**<u>Gjatë vitit 2021: Një marrëveshje e re nënshkruar me Rep. E Shqipërisë</u>** në fushën e sigurimit social.<br><br>Nderkaq nga viti 2018 deri me tani janë nënshkruar katë (4) marrëveshje bilaterale në fushën e sigurimit social.<br><br>Marrëveshja për Sigurime Sociale me **<u>Mbretërinë e Belgjikës</u>** më 20.02.2018 në Bruksel. Ndërsa, Marrëveshja me **<u>Konfederatën e Zvicrës</u>** u nënshkrua më 08.06.2018 në Prishtinë **<u>Gjatë vitit 2020 marrëveshja e re nënshkruar me Holanden</u>** në fushën e sigurimit social, si dhe me 2021 **<u>marrëveshje e re nënshkruar me me Rep. E Shqipërisë.</u>**<br><br>**<u>Pjesërisht e realizuar</u>** |

[33] Të dhënat administrative nga DP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Numri i kërkesave për pensione të jashtme, sipas marrëveshjeve[34] | 400 (gjithsej, që nga viti 2014) | Rritje prej 15% | Rritje prej 30% | Numri i kërkesave dhe lëndëve të proceduara për të gjitha shtetet sipas skemave pensionale për 2022 është:<br>1. Pension të pleqërisë: 314<br>2. Pension invalidor: 11<br>3. Pension familjar: 259<br>4. Kthimi i kontributeve: 21<br>Ndërsa numri i kërkesave për të gjitha shtetet sipas skemave pensionale per 2021 është:<br>1. Pension të pleqërisë: 1403<br>2. Pension invalidor: 92<br>3. Pension familjar: 740<br>4. Kthimi i kontributeve: 9.<br>**Plotësisht e realizuar** |

| **Objektivi specifik 4.4** | **Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit** | **Baza** | **Caku 2020** | **Caku 2022** | **Realizimi i indikatorëve 2022** |
|---|---|---|---|---|---|

[34] Të dhënat administrative nga DP

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Avancimi i menaxhimit dhe administrimit të skemave të pensioneve dhe beneficioneve përmes ngritjes së kapaciteteve institucionale, njerëzore dhe teknologjike** | 1. Numri i skemave të pensioneve dhe beneficioneve të integruara në sistemin e TI-së | skema pensionale + të gjitha skemat e kategoritë të dalura nga lufta | skemat e reja pensionale + skemat e kategorive te luftës | Të gjitha skemat | **Gjatë 2022,** menaxhimin e sistemit të IT për krejt skemat pensionale e administrojnë zyrtaret kompetent.<br>**Vetëm një skeme** është integruar në TI **gjatë vitit 2020.**<br>Sipas raportimit **gjatë 2018**, u integruan **24 skema**. Pra, në total, konsiderohet indikator pjesërisht i realizuar.<br>**Pjesërisht e realizuar** |
| | 2. Përqindja e zyrtarëve (në nivel të departamentit dhe Zyrave të Pensionit) të trajnuar për sistemin e TI-se[35] | Stafi teknik 0/150 | Stafi teknik 28/150 | Stafi teknik 56/150 | **Gjatë vitit 2022**, nuk është mbajtur asnjë trajnim në fushën e IT.<br>Sipas raportimit për vitin 2021, janë mbajtur **(3) trajnime** dhe janë trajnuar 10 **zyrtarë**.<br>Nderkaq sipas raportimit per vitin 2020, janë mbajtur **kater (4) trajnime** dhe janë trajnuar **25 zyrtarë**.<br>**Pjesërisht e realizuar** |
| | 3. Numri i zyrave/objekteve me kushte të përmirësuara të infrastrukturës fizike[36] | 18 zyre | 18 zyre | 16 zyre | **Numri i objekteve ku është nderhyre në permiresimin e kushteve deri me tani:**<br>**Gjatë vitit 2022**, nuk është nderhyr në asnji objekt/zyre të pensioneve për renovime për arsye se nuk kanë kaluar projektet kapitale.<br>**2021 Gjashtë (6)** zyra/objekte te pensioneve të renovuara: Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, Gjakovë.<br>**2018**: **është realizuar vetem 1.** |

[35] DP dhe DFDIL
[36] DP dhe DFDIL

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **Pjesërisht e realizuar** |
| | 4. Institucionet përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e skemave të pensioneve dhe beneficioneve [37] | Skemat e pensioneve dhe beneficioneve menaxhohen dhe rregullohen nga DP dhe DFDIL | Skemat e pensioneve dhe beneficioneve menaxhohen dhe rregullohen nga agjencitë përkatëse | Skemat e pensioneve dhe beneficioneve menaxhohen dhe rregullohen nga agjencitë përkatëse | **Departamenti i Pensioneve menaxhon njëmdhjet (11) Skema Pensionale:**<br>1. Pensionet Bazike<br>2. Pensionet Kontribut pagues<br>3. Pensionet e PPAK-së<br>4. Pensionet e TMK-së<br>5. Pensionet e FSK-së<br>6. Kompensimi për Persona të Verbër<br>7. Pensioni Invalidor i Punës<br>8. Pensioni Familiar<br>9. Kompensimi i Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik<br>10. Pensionet e Parakohshme Trepça<br>11.Kompenzimi për Punëtoret e arsimit nga viti shkollor 1990/1991 deri në vitin 1998/99.<br>Tre (3) Skemat DFDIL<br>1. Pensionet e Familjeve teDeshmoreve dhe Invalideve te luftes<br>2. Pensionet e Veteranëve<br>3. Pensionet e Viktimave te dhunes seksuale.<br>**Plotësisht e realizuar** |

[37] Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës dhe të dhënat administrative te MPMS